

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6173  
E martë, 24 nëntor 2020  
çmimi 0.40 €

Në tremujorin e tretë të 2020-s, MSA-ja është zbatuar 35,59 për qind

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", BEHXHET SHALA | FAQE 4-5



**- Deklarata e kryeprokurorit të Gjykatës Speciale kundër Thaçit, përpjekje për të ndërhyrë në procesin gjyqësor dhe për të krijuar një opinion të pambështetur**

Drejtori ekzekutiv i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj), Behxhet Shala, ka thënë se aktakuzat e Gjykatës Speciale e kanë futur Kosovën në një rrugë qorre. Po ashtu, ai ka thënë se këto aktakuza e kanë degraduar Kosovën në arenën ndërkombëtare, duke e vënë shtetin tonë në pozitë të

pafavorshme ndaj Serbisë e cila ka kryer gjenocid kundër shqiptarëve. Në këtë intervistë për "Epokën e re", Shala ka thënë se shpreson se administrata e Joe Bidenit të ndikojë në mënyrë që Kosova ta kthejë pozitën të cilën e ka pasur më herët. Shala ka thënë se procesi gjyqësor ndaj ish-krerëve të UÇK-së do të jetë maratonik, pa

dashur ta paragjykojë epilogun e këtij procesi. Ai ka reaguar edhe ndaj deklaratës së kryeprokurorit të Gjykatës Speciale, Jack Smith, në lidhje me ish-presidentin Hashim Thaçi, duke theksuar se deklarata e Smithit është përpjekje për të ndërhyrë në procesin gjyqësor kundër ish-drejtimesve të UÇK-së.

INTERVISTË ME ARTISTIN FIGURATIV  
BEDRI KADRIU

## GANIMETE DHE MIFTAR HAJDARI, DY NGA 1392 FËMIJËT VIKTIMA TË GJENOCIDIT SERB NË KOSOVË

FAQE 3

Motër e vëlla, Ganimetja, e lindur më 6 korrik 1984, dhe Miftari, i lindur më 15 dhjetor 1988, janë dy nga 1392 fëmijët shqiptarë, viktima të gjenocidit serb në Kosovë. Ata ishin fëmijët e vetëm të prindërve Bashkim dhe Kadrie Hajdari. Në ditën kur u vranë, 6 prill 1999, është

plagosur edhe nëna e tyre. Ajo i ka mbijetuar plagët. Jo vetëm për të vuajtur gjithë jetën, si mijëra nëna dhe baballarë të tjerë shqiptarë, shkak i vrasjës së engjujve të tyre, por edhe për të dëshmuar për krimet e kryera nga ana e shtetit serb, në raport me shqiptarët

gjatë luftës së fundit në Kosovë. Dëshmia e saj duhet të regjistrohet e ruhet. Së bashku me mijëra dëshmi e fakte tjera, ajo duhet të shërbejë si bazë për ndriçimin dhe njohjen ndërkombëtare të gjenocidit serb dhe për kallëzim penal ndaj Serbisë...



### OPINION

**SHQIPËRIA DHE MAQEDONIA  
E VERIUT SFIDOHEN SËRISH  
NË BE** F. 11

Prof. Lisen  
BASHKURTI



### AKTUALE



**ANTONY BLINKEN PRITET TË  
EMËROHET SEKRETAR AMERIKAN  
I SHTETIT** F. 2

**12 TË VDEKUR DHE 645 RASTE  
TË REJA ME COVID NË KOSOVË**

F. 6

### EKONOMI



**APLIKIMI PËR KARTONIN  
E GJELBËR, VETËM  
PAS SHTATORIT 2021** F. 9

### KULTURË

**I JEPET LAMTUMIRA  
KËNGËTARIT ISMET PEJA** F. 10



**Kolegji  
BIZNESI**

[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net



**INFINITY**  
Digital Agency

Endrit Shaqiri  
+38344685122

Internet Website,  
Marketing...

## Kamberi: Pasivizimi i adresave të shqiptarëve po ndryshon strukturën etnike në Luginën e Preshevës

PRISHTINË, 23 NËNTOR- Deputeti shqiptar në Parlamentin e Serbisë, Shaip Kamberi ka bërë me dije se ka vite që Serbia ka nisur pasivizimin e adresave të shqiptarëve që jetojnë në tri komunat jugore, në Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc dhe kjo sipas tij, po ndryshon "strukturën etnike" të këtyre komunave, që ndryshe njihen me termin Luginë e Preshevës.

Në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë", Kamberi thotë se mirëpret reagimin e kryediplomatëve të Kosovës dhe Shqipërisë, që kërkojnë që Serbia të ndalë fshirjen e qëllimshme të adresave të shqiptarëve në Luginë të Preshevës. "Po, ky është një proces që ka filluar para disa vjetësh. Më intensivisht është duke u zbatuar në Medvegje në shqiptarët që në '99-n janë larguar dhunshëm nga Medvegja dhe jetojnë në Kosovë, nuk e kanë të rregulluar statusin civil në Kosovë, që do të thotë se akoma janë shtetas edhe me vendbanim në Medvegje. Por, në kuadër të ligjit për caktimin e vendbanimit po shfrytëzohet një dispozitë e

cila thotë se nëse qytetari nuk është duke banuar në vendbanimin që e ka paraqitur, atëherë ai vendbanim pasivizohet. Këtu është fjala për pasivizimin e vendbanimeve", ka thënë Kamberi.

Ai ka shtuar se qytetarëve të cilët iu pasivizohet adresa, mund të kërkojnë të regjistrojnë një vendbanim të ri, por ai shprehet se kjo bëhet përmes një procedure të stërzgatur.

Kamberi ka theksuar se nuk ka informacione të sakta se cili është numri i qytetarëve të cilëve u janë fshirë adresat në Medvegje, por një numër të përafërt e nxjerr nga regjistri zgjedhor. "Sipas informacioneve që i kemi tani,

së paku te regjistrat zgjedhor, sepse me humbjen e vendbanimeve qytetari humb edhe të drejtën e votës. Janë diku 1,200 persona që janë fshirë në Medvegje, pra të moshës madhore, mbi 18 vjeç", thotë ai, duke shtuar se nuk kanë të dhëna për qytetarët nën moshën 18 vjeçe. "Shqiptarët, deri më 2018, sipas regjistrat zgjedhor i kanë pasur 8 këshilltarë në



Kuvendin komunal të Medvegjës. Me pasivizimin e adresave ata kanë rënë në 3. Kjo nënkupton një ndryshim drastik të strukturës etnike të komunës", ka pohuar Kamberi. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Kosovës, Meliza Haradinaj-Stublla dhe ministri në detyrë i Punëve të

Jashtme të Shqipërisë, Gent Cakaj, përmes një deklarate të përbashkët, ka theksuar se ky proces që po bëhet në Serbi, përbën formë të re të "shtypjes ndaj shqiptarëve të Luginës së Preshevës". "Prandaj, ndërsa ne e dënojmë fuqimisht këtë praktikë institucionale, u bëjmë thirrje autoriteteve të Serbisë ta

ndërpresin menjëherë punën sistematike për pasivizimin e adresave të shqiptarëve. Kjo praktikë shtetërore nuk dëmton vetëm të drejtat e shqiptarëve në Luginën e Preshevës, por është edhe një shpërfillje e plotë të standardeve demokratike në përgjithësi", thuhet në deklaratën e përbashkët të shefave të diplomacisë të Kosovës dhe Shqipërisë.

Deputeti Kamberi ka theksuar se ndonëse Medvegja është më e prekur nga pasivizimi i vendbanimeve, ky proces po zhvillohet edhe në dy komunat tjera të banuara me shqiptarë, Preshevë dhe Bujanoc.

Ai shpreh edhe shqetësimin që shqiptarët që janë larguar nga Luginë e Preshevës drejt Kosovës që nga viti 1999, nuk e kanë të rregulluar statusin civil as në Kosovë. "Në Kosovë, shumica prej tyre nuk e kanë të rregulluar gjendjen civile, kështu që mbeten persona, atë që terminologjia juridike në Serbi i quan 'persona juridikisht të padukshëm'", ka thënë ai. Në Serbi nuk ka numër të saktë të banorëve shqiptarë, pasi shqiptarët patën bojkotuar regjistrimin e popullsisë të bërë më 2011.

## Vaksina e Oksfordit tregon 70 për qind mbrojtje ndaj koronavirusit



Londër, 23 nëntor- Vaksina për koronavirus, e zhvilluar nga Universiteti i Oksfordit, parandalon shfaqjen e simptomave të këtij virusi te njerëzit për 70 për qind, kanë treguar të dhënat e një studimi të madh. Ky lajm përbën triumf dhe zhgënjim, pasi vaksinat e prodhuara nga kompanitë Pfizer dhe Moderna, tregojnë për 95 për qind mbrojtje, raporton "BBC".

Megjithatë, vaksina e Oksfordit është thënë se do të jetë shumë më e lirë, më e lehtë për t'u ruajtur dhe më lehtë e qasshme në secilin kënd të botës, në krahasim me dy të tjerat. Nëse miratohet nga rregullatorët, ajo besohet se mund të luajë rol të rëndësishëm në luftimin e pandemisë. Huluntuesit e Oksfordit kanë kryer për 10 muaj, testimet për vaksina që

zakonisht kryhen për një dekadë. "Njoftimi i sotëm na çon një hap më afër kohës kur mund të përdorim vaksinat dhe t'i japim fund shkatërrimit të shkaktuar nga virusi", ka thënë arkitektja e vaksinës, Sarah Gilbert. Qeveria britanike ka porositur deri më tani 100 milionë doza të vaksinës së Oksfordit, të mjaftueshme për të imunizuar 50 milionë banorë.

## Antony Blinken pritet të emërohet Sekretar amerikan i Shtetit

WASHINGTON, 23 NËNTOR- Presidenti i zgjedhur amerikan, Joe Biden pritet të zgjedhë këshilltarin e tij dhe diplomatit veteran, Antony Blinken si Sekretar Shteti, kanë raportuar mediet amerikane. Nëse nominohet dhe konfirmohet nga Senati, Blinken do të ketë detyrë krijimin e një qasje të re të diplomacisë amerikane dhe bashkëpunimit global, pas

katër vjetëve të politikës "Amerika e Para" e presidentit aktual, Donald Trump, e cila është përcjellë me ndasi në institucionet ndërkombëtare dhe përplasje me aleatët dhe konkurrentët. Biden do ta bëjë këtë njoftim më 24 nëntor, teksa do të publikojë emrat e parë në kabinetin e tij. Jake Sullivan, ndihmës i ngushtë i ish-Sekretares amerikane të Shtetit, Hillary

Clinton, pritet të emërohet Këshilltar për Siguri Kombëtare i Bidenit.

Emërimi i Blinkenit, që është raportuar fillimisht nga Bloomberg dhe më vonë është konfirmuar edhe nga media tjera, vjen teksa Biden vazhdon të zgjerojë administratën e tij, pavarësisht tentimeve të Trumpit për të përmbysur rezultatin zgjedhor.



Intervistë me artistin figurativ Bedri Kadriu

# GANIMETE DHE MIFTAR HAJDARI, DY NGA 1392 FËMIJËT VIKTIMA TË GJENOCIDIT SERB NË KOSOVË

Lulëzim ETEMAJ

Motër e vëlla, Ganimetja, e lindur më 6 korrik 1984, dhe Miftari, i lindur më 15 dhjetor 1988, janë dy nga 1392 fëmijët shqiptarë, viktimat e gjenocidit serb në Kosovë. Ata ishin fëmijët e vetëm të prindërve Bashkim dhe Kadrie Hajdari. Në ditën kur u vranë, 6 prill 1999, është plagosur edhe nëna e tyre. Ajo i ka mbijetuar plagët. Jo vetëm për të vuajtur gjithë jetën, si mijëra nëna dhe baballarë të tjerë shqiptarë, shkak i vrasjes së engjujve të tyre, por edhe për të dëshmuar për krimet e kryera nga ana e shtetit serb, në raport me shqiptarët gjatë luftës së fundit në Kosovë. Dëshmia e saj duhet të regjistrohet e ruhet. Së bashku me mijëra dëshmi e fakte tjera, ajo duhet të shërbejë si bazë për ndriçimin dhe njohjen ndërkombëtare të gjenocidit serb dhe për kallëzim penal ndaj Serbisë.

1392 fëmijët e vranë meritojnë drejtësi! Drejtësia për ta nuk duhet të mungojë edhe më tutje! Ganimetes dhe Miftarit u është ngritur këto ditë një monument kujtimi në shkollën e fshatit, ku ata vijonin mësimet, njëri në klasën e 8-të, ndërsa tjetri në atë të 4-të. Autor i tij është artisti figurativ Bedri Kadriu.

“Kujtimi i vazhdueshëm i këtyre dy nxënësve të pafajshëm, të vranë nga dora e serbit vetëm pse ishin shqiptarë”, ishte përgjigja e Kadriut, gjatë intervistës së zhvilluar me të për gazetën “Epoka e re”, mbi mesazhin që bartë në vete kjo vepër arti.

“Epoka e re”: Zotëri Kadriu, ju



këto ditë i kthyet sërish në shkollën “Sheqë Mirofci” në Shtedim të Besianës, fëmijët, motër e vëlla, Ganimete (14 vjeç) dhe Miftar Hajdari (10 vjeç). Veçese kësaj here kthimi i tyre u bë në bronz. Çfarë mund të na thuani ju lutem për rrethanat e vrasjes së tyre?

**Bedri Kadriu:** Më datën 17 nëntor 2020 kam realizuar këtë skulpturë, si monument përkujtimor, dedikuar këtyre fëmijëve të rënë gjatë luftës në Kosovë. Skulptura është e para e këtij lloji në vend, e realizuar përgjithësisht për fëmijët shqiptarë, viktimat të gjenocidit

serb. Ndjem më fat që ia arrita t'i kthej në shkollë në formë artistike, të derdhur në bronz, që të zënë vend dhe të mbesin përgjithmonë në kujtimet e secilit nxënës, brez pas brezi. Dhe jo vetëm.

Këta dy fëmijë janë vranë pas granatimeve që u janë bërë nga forcat serbe popullatës civile shqiptare, kryesisht gra, pleq, fëmijë, në fshatin Shamalluk të Besianës. Fillimisht është vranë Miftari, më pastaj e motra, Ganimetja. Nëna e tyre i ka mbijetuar plagët e marrura me këtë rast.



Si iniciativa ashtu dhe projekti për memorialin ka qenë i imi. Financimi është bërë nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale.

“Epoka e re”: Sa e bukur buzëqeshja e tyre, sadoqë e ngrirë! Si artist, anipse nuk është e preferueshme interpretimi i veprave personale, a na thuani ju lutem, se cili është mesazhi i veprës suaj, përtej buzëqeshjes së tyre engjullore dhe librit që Ganimetja e bart në duar?

**Bedri Kadriu:** Mesazhi i monumentit është kujtimi i vazhdueshëm i këtyre dy nxënësve të pafajshëm, të vranë nga dora e serbit vetëm se ishin shqiptarë. Buzëqeshja përçon mesazhin e dashurisë së tyre si dhe të çdo fëmijë për jetën, për ta jetuar atë të lirë e të buzëqeshur, pranë moshatarëve, që ndjekun mësimet dhe pajisen me dituri për të ardhmen. Kurse libri, të cilin e bartë Ganimetja, kuptohet, përçon mesazhin e përkushtimit dhe dashurisë ndaj dijes, shkollimit, i cili hap horizonte të reja jetësore. Të veshur njësoj, ata na flasin se sa të afërt ishin mes vete, sa të gëzuar e të sigurtë krah njëri-tjetrit, si në jetë ashtu dhe në vdekje. Të mos harrojmë, Ganimetja është plagosur dhe ka vdekur me vëllanë e marrë në gjoks, pasi ai ishte vranë paraprakisht.

1392 fëmijët viktimat të krimit gjenocidar serb në Kosovë. Çfarë mendoni ju se duhet të bëjë për këta fëmijë shteti i Kosovës?

**Bedri Kadriu:** Ashtu si Ganimetja dhe Miftari, edhe 1390 fëmijët tjerë janë fëmijë të pafajshëm, të privuar pafajësisht nga jeta, të ndarë poashtu pafajësisht nga fëmijët tjerë, prindërit e tyre, rrethi, vendi i tyre. Shteti duhet të punojë shumë, të ndriçojë rrethanat e vrasjes radhë më radhë të çdonjërit prej tyre. Ata meritojnë drejtësi. E, ajo mungon ende, përdërisa nuk ka padi nga shteti i Kosovës, as për kryerësit e krimit, as për planifikuesit dhe urdhërdhënësin, shtetin serb. Një monument i përbashkët për të gjithë këta fëmijë është më se i domosdoshëm. Shteti i Kosovës e ka në themelet e tij edhe gjakun e këtyre filizave. Ata, por edhe familjet e tyre, meritojnë më shumë vëmendje dhe kujdes, si nga shteti ashtu dhe nga çdo qytetar.

Mbetet detyrë e ne artistëve të realizojmë vepra arti, të fushave dhe gjinive të ndryshme, kushtuar shqiptarëve, të të gjitha moshave, të rënë në luftë, përfshirë domosdoshmërisht edhe viktimat e gjenocidit të shtetit serb në Kosovë, duke filluar nga filmi, teatri, piktura, skulptura, letërsia, muzika.

Dëshmo, për të mos harruar!  
Denoncoje Serbinë!

<https://kosovogencide.com>

“Epoka e re”: Ganimetja dhe Miftari, e thamë, janë dy nga





FLET PËR "EPOKËN E RE", BEHXHET SHALA

# AKTAKUZAT E SPECIALES E KANË FUTUR KOSOVËN NË NJË RRUGË QORRE

- Deklarata e kryeprokurorit të Gjykatës Speciale kundër Thaçit, përpjekje për të ndërhyrë në procesin gjyqësor dhe për të krijuar një opinion të pambështetur

Drejtori ekzekutiv i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj), Behxhet Shala, ka thënë se aktakuzat e Gjykatës Speciale e kanë futur Kosovën në një rrugë qorre. Po ashtu, ai ka thënë se këto aktakuza e kanë degraduar Kosovën në arenën ndërkombëtare, duke e vënë shtetin tonë në pozitë të pafavorshme ndaj Serbisë e cila ka kryer gjenocid kundër shqiptarëve. Në këtë intervistë për "Epokën e re", Shala ka thënë se shpreson se administrata e Joe Bidenit të ndikojë në mënyrë që Kosova ta kthejë pozitën të cilën e ka pasur më herët. Shala ka thënë se procesi gjyqësor ndaj ish-krerëve të UÇK-së do të jetë maratonik, pa dashur ta paragjykojë epilogun e këtij procesi. Ai ka reaguar edhe ndaj deklaratës së kryeprokurorit të Gjykatës Speciale, Jack Smith, në lidhje me ish-presidentin Hashim Thaçi, duke theksuar se deklarata e Smithit është përpjekje për të ndërhyrë në procesin gjyqësor kundër ish-drejtesve të UÇK-së

është bërë partnere serioze e Bashkimit Evropian (BE) dhe e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA). Ndërsa Kosova, edhe pse viktimë e gjenocidit serb, është vendosur para një tribunali apo para një gjykate speciale, e cila vetëm mund të thuhet se është pjesë e sistemit juridik të Kosovës por që, në fakt, është gjykatë 100 për qind ndërkombëtare dhe kjo e ka sjellë vendin tonë në një situatë shumë të vështirë. Po ashtu, kjo gjykatë e ka bërë një përçarje të madhe midis shqiptarëve. Dikush është gëzuar, dikush është hidhëruar nga kjo gjykatë apo ka edhe të atillë që mendojnë të përfitojnë politikisht nga kjo situatë. Aktakuzat e kësaj gjykate kanë shkaktuar edhe krizën rreth pozitës të presidentit duke e futur Kosovën në një rrugë qorre. Tani e gjitha çfarë ka mbetur është që të shpresohet

se mos administrata e re amerikane, ajo e Joe Bidenit, do të ndikojë në mënyrë që kjo situatë të përmirësohet apo Kosova ta kthejë pozitën të cilën e ka pasur më herët.

**"Epoka e re":** Cilat janë pritjet e juaja nga ky proces gjyqësor?

**Shala:** Si Këshill për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj), por edhe si drejtor i këtij këshilli nuk e prezumojmë pafajësinë e askujt. Ne nuk themi se dikush është apo nuk është fajtor. Kjo është çështje e gjykatave. Ne angazhohemi që të akuzuarit ta kenë një proces gjyqësor të pandikuar, të drejtë dhe të kenë mundësi të mbrohen nga akuzat që i ngarkon Prokuroria e Gjykatës Speciale. Kjo është puna jonë. Përndryshe ne nuk mund të paragjykojmë se cili mund të jetë epilogu i kësaj gjykate. Realisht këtë nuk mund ta

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 23 NËNTOR -  
"Epoka e re": Z. Shala, si i vlerësoni zhvillimet në vend pas konfirmimit të aktakuzave kundër ish-drejtesve kryesorë të UÇK-së nga Gjykata Speciale?

**Shala:** Çdokush që e ka përcjellë nga fillimi këtë proces e ka ditur se do të ketë aktakuza, ndërsa se kush do të ishte pjesë e aktakuzave, më shumë ka qenë çështje e parashikimeve të ndryshme, preferencave politike apo personale që kanë pasur persona të caktuar.

Definitivisht, konfirmimi i aktakuzave nga Gjykata Speciale e ka futur Kosovën në një krizë, duke e degraduar atë në planin ndërkombëtar, pra duke e vënë Kosovën në pozitë të pafavorshme ndaj Serbisë, për faktin se Serbia si shkaktare dhe zbatuese e gjenocidit në Kosovë

parashikojë askush. Këtë mund ta bëjë vetëm dikush i cili është pjesë e kurdijes së një procesi, i cili mund ta dijë paraprakisht se cili do të jetë epilogu i atij procesi gjyqësor. Pra, ky është një proces i gjatë, ku do të ketë përbalje edhe të prokurorisë edhe të mbrojtjes, gjithashtu edhe të dëshmitarëve dhe të dëmtuarve. Dhe, krejt në fund, Gjykata Speciale do të duhej ta merrte një vendim në përputhje me provat e paraqitura. Prandaj, çdokush që del me një parashikim, siç ka dalë kryeprokurori i kësaj gjykate, Jack Smith, i cili ka thënë se Hashim Thaçi do të dënohet me burgim të përjetshëm, është paragjykes dhe ndërhyrës dhe këtu ka përpjekje për të ndikuar në Gjykatën Speciale. Po me këtë deklaratë ai ka për qëllim që ta shtrembërojë opinionin edhe pse ai nuk ka të drejtë ta japë një deklaratë të tillë.

**“Epoka e re”:** KMDLNj-ja, të cilën e drejtoni ju, ka denoncuar publikisht kryeprokurorin e Gjykatës Speciale, Jack Smith, për ndërhyrje në procesin gjyqësor. Për çfarë ndërhyrjesh e keni fjalën?

**Shala:** Siç e thashë më parë, në një deklaratë apo në një

intervistë kryeprokurori i Gjykatës Speciale ka deklaruar se Hashim Thaçi duhet të dënohet me burgim të përjetshëm. Kjo nuk është puna e tij. Puna e tij është që ta parashtrijë aktakuzën dhe ta mbrojë atë duke u ballafaquar me mbrojtjen. Po ashtu, puna e tij është që ta mbrojë interesin e viktimës, pastaj gjykata vendos se kush ka faj apo kush është i pafajshëm. Pra, ai (Jack Smith) nuk ka të drejtë të thotë as do të dënohet e as do të lirohet dikush. Kjo nuk është kompetencë e tij. Deklarata e tij është një përpjekje për të ndërhyrë në procesin gjyqësor dhe për të krijuar një opinion të pambështetur në një vendim gjyqësor. Për këtë arsye kemi vlerësuar se deklarata e tij është e papranueshme. Asnjë gjykatë për krime lufte që nga Gjykata e Nurembergut, Tribunali i Hagës për ish-Jugosllavinë, Gjyqi Special në Ruandë, Sudan, Liban nuk ka vepruar kështu, ku pasi janë ngritur aktakuzat, të bëhet apel që të lajmërohen dëshmitarët dhe të dëmtuarit. E kemi një aktakuzë dhe e kemi një proces gjyqësor që ka filluar dhe prokuroria merret me çështjet të cilat i ka parashtruar në aktakuzë. Mirëpo po e shihni

se Gjykata Speciale vetëm formalisht është gjykatë e Kosovës, por nuk funksionon sipas ligjeve tona. Nuk u jep llogari institucioneve të Kosovës dhe nuk e ka asnjë shenjë që e identifikon me Kosovën. Materialet e punës janë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe. Ju e keni dëgjuar Meliza Haradinaj-Stubllan se institucionet e Kosovës me Gjykatën Speciale komunikojnë vetëm me nota verbale. Komunikimi me nota verbale është komunikim vetëm i shtetit me shtet. A keni dëgjuar që Ministria e Drejtësisë të komunikojë me notë verbale me institucionet e tjera të shtetit të Kosovës, duke përfshirë Gjykatën Supreme apo atë të Apelit?! Pra një gjë e tillë është praktikë e komunikimit të dy shteteve. Prandaj ne e kemi vlerësuar në këtë aspekt se kryeprokurori Jack Smith i ka tejkaluar kompetencat e veta. Ai nuk ka të drejtë ta paragjykojë fajësinë e askujt sikurse nuk ka të drejtë ta paragjykojë as pafajësinë e askujt, sepse nëse prokuroria do të thoshte se dikush është i pafajshëm, atëherë ndaj tij ose atyre nuk do të ngrihej ndonjë aktakuzë.

**“Epoka e re”:** Çfarë ndikimi mund të ketë procesi gjyqësor në Hagë në raport me të ardhmen e Kosovës?

**Shala:** Ky proces gjyqësor e ka dëmtuar Kosovën mjaft. Si KMDLNj gjithmonë kemi qenë në anën e viktimave. Ne asnjëherë nuk kemi dashur t'i ndajmë viktimat në bazë të përkatësisë etnike, politike, fetare apo në bazë të statusit shoqëror. Pra, viktimën e kemi trajtuar si viktimë dhe gjithmonë kemi kërkuar drejtësi, sikurse kemi kërkuar edhe përgjegjësi për ata që kanë bërë krime, po me të njëjtat parime. Kurrë nuk kemi thënë se dikush është i fajshëm apo i pafajshëm, por ia kemi lënë gjykatës të vendosë. Tash kjo gjykatë po e shkel parimin e trajtimit të viktimave në mënyrë të barabartë. Kjo gjykatë është duke diskriminuar viktimat, ku 95 për qind e viktimave nga lufta janë të përkatësisë kombëtare shqiptare dhe të cilat nuk janë duke u trajtuar. Realisht edhe viktimat e tjera duhet të trajtohen, por disa viktimat që janë përmendur në aktakuzë janë vlarë nga vetë regjimi serb. Pra, ky proces gjyqësor do të ishte në rregull sikur Gjykata Speciale do t'i trajtonte të gjitha rastet e mbetura nga Tribunali i Hagës, UNMIK-u dhe EULEX-i. Ne do të insistojmë që të trajtohen të gjitha krimet, por në qoftë se bëhet një prerje duke diskriminuar një pjesë të madhe të viktimave dhe duke amnistuar pjesën dërrmuese të atyre që kanë bërë krime, atëherë këtë gjykatë nuk mund ta vlerësojmë si të drejtë në asnjë mënyrë, sepse nuk siguron drejtësi për viktimat dhe nuk i trajton ato në mënyrë të barabartë.

**“Epoka e re”:** Z. Shala, aktakuzat e Speciales kanë bërë që Thaçi të japë dorëheqje nga posti i presidentit, duke e lënë Kosovën me ushtrues të detyrës së shëfës së shtetit. Në këtë drejtim, a kanë kapacitet partitë parlamentare që ta zgjedhin një president të ri pa shkuar në zgjedhje?

**Shala:** Realisht e kemi një situatë politike e cila kërkon

zgjidhje. Sipas meje, partitë politike duhet të ulen dhe të bëjnë përpjekje për ta zgjedhur presidentin. Në qoftë se nuk arrijnë një marrëveshje procedurale për presidentin, atëherë partitë politike do të duhej të merren vesh për datën e zgjedhjeve, të cilat do të duhej të mbaheshin jo më herët se në muajin qershor të vitit 2021. Për shkak të situatës dhe procedurave, është e pamundur të mbahen zgjedhjet para kësaj kohe. Në anën tjetër, e kemi një situatë ku disa parti politike janë të interesuara t'ia shkurtojnë mandatin ushtrueses së detyrës së presidentes, ndërsa disa të tjera janë të interesuara që Vjosa Osmani të qëndrojë në këtë pozitë. Unë mendoj se disa parti do të bëjnë përpjekje maksimale që ta gjejnë një kandidat për president në mënyrë që ta nxjerrin Vjosa Osmanin nga zyra e presidentit, të cilën në asnjë mënyrë nuk mund ta paramendojnë në atë zyrë qoftë edhe si ushtruese e detyrës së presidentit. Pra ata do të bëjnë përpjekje që ta zgjedhin presidentin e ri. Në anën tjetër, pas zgjedhjeve në Podujevë që do të mbahen këtë javë, do ta kemi një situatë më të qartë sepse PDK-ja është duke luajtur një rol enigmatik politik. PDK-ja është duke e përdorur taktikën “as mish e as peshk”, pra as në pozitë e as në opozitë. Ju e keni parë se kohën e fundit ka një lloj koketimi në mes të LDK-së dhe të PDK-së për një koalicion të mundshëm. Në këtë kontekst, PDK-ja ka vendosur të mbetet në opozitë, ndonëse unë kam dyshime të mëdha sepse tani kemi një situatë krejtësisht të re. PDK-ja nuk duhet të deklarohet se është e interesuar për postin e presidentit apo ta vë si kusht për ndonjë koalicion në të ardhmen me LDK-në këtë post. PDK-ja është duke prekur në “kulaç” dhe vlerësoj se brenda kësaj partie ka të interesuar që të hyhet në koalicion me LDK-në dhe kjo ndoshta e krijon mundësinë që PDK-ja si kompensim të pozitës të presidentit mund t'i marrë disa ministri të fuqishme, ndërsa postin e presidentit t'ia lë qoftë AAK-së apo dikujt tjetër.



## Hoxhaj, Kosnett: Kosova është falënderuese për përkrahjen e ShBA-ve në kohë pandemie


PRISHTINË, 23 NËNTOR (ER)- Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka zhvilluar një takim virtual me ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Philip Kosnett, ku kanë diskutuar për situatën aktuale në Kosovë, përfshirë urgjencën e përbaljes me pandeminë dhe menaxhimin e ekonomisë. Hoxhaj e falënderoi ambasadorin Amerikan për

përkrahjen e vazhdueshme që vendi i tij i ka dhënë Kosovës. “PDK-ja si parti opozitare dhe si parti shtetformuese ka treguar një qasje konstruktive në raport me çdo proces politik. Situata e Kosovës është e rëndë dhe PDK është duke e përcjellë me shqetësim të vazhdueshëm qasjen e qeverisë karshi menaxhimit të pandemisë dhe krizës ekonomike”, ka thënë Hoxhaj.



Reagim i KMDLNj-së

# Kryeprokurori Jack Smith po e shkel parimin e prezumimit të pafajësisë!



Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale në Hagë, Jack Smith, në paraqitjet publike po ndërhyjnë në procesin gjyqësor ndaj të akuzuarve; Salih Mustafa, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucati të cilët po mbahen të paraburgosur në Qendrën e Paraburgimit në Hagë, në një Gjykatë 100 për qind ndërkombëtare, e ambalazhuar si gjykatë e Kosovës duke ndërhyrë në procesin gjyqësor që nënkupton se të akuzuarit po i nënshtrohen një trajtimi diskriminues për faktin se, ende pa përfunduar hetimet dhe një proces gjyqësor po prezumohet pafajësia e tyre e që është shkelje e të drejtave të njeriut të personave të arrestuar për një proces të drejtë, të paanshëm dhe pa ndërhyrje.

Një gjykimi i drejtë dhe i pandikuar garantohet me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara përkatësisht të neneve 7, 8, 10 e në veçanti të nenit 11 ku shprehimisht thuhet se: "Kushdo që është i arrestuar për një vepër penale ka të drejtë të konsiderohet i pafajshëm deri sa të vërtetohet fajësia në bazë të ligjit dhe në një proces publik në të cilin ka pasur të gjitha garancitë e duhura për mbrojtjen e vet..."

Po këto të drejta u garantohen me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kryeprokurori Smith thotë se Hashim Thaçi do të dënohet me burg të përjetshëm duke marrë kompetencat e trupit gjyqësor, ende pa përfunduar procedimi i provave pas së cilave vetëm gjykata kompetente, me një vendim të formës së prerë e përcakton shkallën e fajësisë apo të pafajësisë për çdo të akuzuar e që është subjekt i kësaj gjykate.

Kryeprokurori është përfaqësues dhe mbrojtës i aktakuzës kundër të akuzuarve por, në asnjë rast nuk është ai që e merr një vendim gjyqësor. Është e drejtë e Prokurorisë dhe prokurorit të rastit që pas përfundimit të procedimit të provave, në fjalën përfundimtare të propozojë masën e dënimit për të akuzuarit por se nuk ka asnjë të drejtë, si në një bastore gjyqësore të parashikojë apo të pohojë se Hashim Thaçi apo kushdo tjetër do të dënohet me burg të përjetshëm përveç nëse ka informata të sigurta se kështu edhe do të ndodhë, ende pa përfunduar gjykimi e që është një qasje krejtësisht joprofesionale dhe në kundërshtim me mandatin që e ka sikur edhe përpjekje për ndërhyrje dhe ndikim në

punën e Gjykatës Speciale. Këto deklarata të kryeprokurorit do të dënoheshin edhe në regjimet diktatoriale e lëre më te kjo gjykatë që të drejtat e njeriut, në radhë të parë të viktimave por edhe të akuzuarve, e përdor si alfa dhe omega e gjithë veprimtarisë prandaj edhe e ka Ombudspersonin dhe Gjykatën Kushtetuese të Speciales. Ftesa e Prokurorisë së Speciales, pasi janë ngritur aktakuzat se të dëmtuarit dhe dëshmitarët mund të lajmërohen në këtë Prokurori dhe me vete mund të sjellim material dëshmuar paraqet presedan e që nuk është praktikuar në asnjë gjykatë për krime lufte deri më tani, qoftë ajo 100 për qind ndërkombëtare apo hibride.

Ministrja për Punë të Jashtme e Kosovës, znj. Meliza Haradinaj në një prononcim ka deklaruar se me Gjykatën Speciale komunikojnë vetëm përmes notave verbale e që nënkupton se komunikojnë sikur me shtetet tjera në kohën kur publikisht thuhet se kjo Gjykatë Speciale është pjesë e sistemit juridik të Kosovës dhe punon sipas ligjeve të Kosovës. Deputetët e Kuvendit të Kosovës duhet ta thërrasin në interpelancë ministren Meliza Haradinaj dhe përfundimisht të sqarohet mandati i Gjykatës Speciale sikur edhe të

përcaktohet pronësia ; nëse është e Kosovës duhet t'i përgjigjet autoriteteve kosovare dhe në çdo dokument duhet të ketë logon e institucioneve të Kosovës, në të kundërtën duhet të largohen spekulimet se është pjesë e sistemit juridik të Kosovës.

KMDLNj e denoncon publikisht kryeprokurorin e Gjykatës Speciale, Jack Smith për ndërhyrje në procesin gjyqësor, përpjekjes për ndikim në punën e gjykatës sikur edhe shkeljes së rëndë që iu bëhet të drejtave të personave të akuzuar përmes shkeljes së parimit elementar siç është prezumimi i pafajësisë përmes deklaratave publike dhe intervistave, që, në fund të fundit përbënë konflikt të interesit. Detyra e Prokurorisë dhe përfaqësuesit të Prokurorisë është sigurimi i provave kredibile për dëshmim të fajësisë së të akuzuarve sepse përfaqëson interesin e viktimave por se gjykata është ajo që e merr një vendim përfundimtar, pas procedimit të provave duke krijuar kushte për një proces gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm. Në rastin konkret kryeprokurori Jack Smith është i anshëm dhe paragjykes. Prandaj që në fillim e komprometon procesin gjyqësor duke e bërë pak ose aspak të besueshëm!

## 12 të vdekur dhe 645 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 23 NËNTOR (ER)- Të hënën në Kosovë janë konfirmuar edhe 645 raste të reja të të infektuarve me Covid-19. Sipas raportit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të dhënat janë në bazë të 1 542 mostrave të testuara. Gjatë 24 orëve të fundit janë regjistruar edhe 12 vdekje të lidhura me sëmundjen Covid-19. "Rastet e vdekjes janë nga komunat: Gjilan 2 raste (80, 72 vjeç), Pejë 2 (88, 75 vjeç), Deçan 1 (85 vjeç), Ferizaj 1 (76 vjeç), Gjakovë 1 (68 vjeç), Mitrovicë 1 (53 vjeç), Prishtinë 1 (86 vjeç), Prizren 1 (82 vjeç), Rahovec 1 (80 vjeç), Shtime 1 (71 vjeç)", ka njoftuar IKShPK-ja. Autoritetet shëndetësore kanë konfirmuar shërimin edhe të 353 pacientëve ndërsa raste aktive janë 12 618. Që nga fillimi i pandemisë në Kosovë janë infektuar gjithsej 34 940 persona, prej të cilëve 926 kanë vdekur ndërsa 21 396 janë shëruar.

## MSh-ja pajis me pesë rëntgenë mobilë ShSKUK-në

PRISHTINË, 23 NËNTOR (ER)- Ministria e Shëndetësisë e ka pajisur Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës me pesë rëntgenë mobilë, pjesë e projektit të Shëndetësisë Kosovare, i financuar me huamarrje nga Banka Botërore.

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, pret që pajisjet e reja mjekësore të lehtësojnë punën e profesionistëve shëndetësorë për trajtimin e pacientëve me Covid-19.

Sipas planifikimeve, tre rëntgenë do të shkojnë për Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, kurse dy të tjerë për Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit. Në kuadër të Projektit të Shëndetësisë Kosovare, ditëve në vijim, do të mbërrijnë edhe dy rëntgenë statikë, 70 shtretër intensivë, 325 monitorë me parametra të pacientëve dhe 11 spirometër (mjet që mat në mënyrë efektive dhe të shpejtë zbrazjen e mushkërive).

# Në tremujorin e tretë të 2020-s, MSA-ja është zbatuar 35,59 për qind



Kabineti qeveritar është informuar të hënën me raportin rreth zbatimit të Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit gjatë periudhës korrik-shtator 2020. Gjetjet tregojnë se gjatë tremujorit të tretë 2020, ky program është zbatuar në nivel të 35,59 për qind; 21 nga 59 masat e planifikuara për këtë tremujor janë zbatuar plotësisht, ndërsa 64.41 për qind, 38 masa, akoma nuk janë zbatuar plotësisht

## EPOKA ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 NËNTOR- Qeveria e Kosovës, e drejtuar nga kryeministri Avdullah Hoti, ka zhvilluar të hënën mbledhjen e saj të rregullt, me radhë, ku ka shqyrtuar dhe miratuar vendime dhe dokumente të përgjegjësive të saj kushtetuese dhe ligjore.

Në këtë mbledhje kabineti qeveritar është informuar me Raportin mbi zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit gjatë periudhës korrik-shtator 2020. Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së është dokument ligjorisht i

detyrueshëm për të gjitha organet e administratës shtetërore për zbatimin e masave afatshkurtra nën përgjegjësitë e tyre. Qeveria si mekanizëm qendror kombëtar, përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së e mbikëqyrë zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Gjetjet tregojnë se gjatë tremujorit të tretë 2020, Programi është zbatuar në nivel të 35,59 për qind; 21 nga 59 masat e planifikuara për këtë tremujor janë zbatuar plotësisht, ndërsa 64.41 për qind, 38 masa, akoma nuk janë zbatuar plotësisht. Deri në fund të tremujorit të tretë 2020, Programi është zbatuar në shkallën prej 19.07 për qind

ose 37 nga 194 masat e planifikuara janë zbatuar plotësisht, ndërsa 80.93 për qind e tyre (157) akoma nuk janë zbatuar plotësisht. Nga 37 masat e zbatuara, 16 janë zbatuar para afatit të paraparë. Po ashtu është miratuar edhe vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për vazhdimin e mandatit të Komisionit qeveritar për njohjen e statusit të ish të dënuarve dhe ish të përndjekurve politik. Me ndryshimet e aprovuara, në bazë të vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në vend të Artan Abrashit, përfaqësues nga Kuvendi i Kosovës, emërohet Donika Kadaj-Bujupi, ndërsa sipas

propozimit të Shoqatës së Juristëve, përfaqësues nga Shoqatat e Juristëve emërohet Mazlum Baraliu.

Në vazhdim të mbledhjes është miratuar vendimi sipas të cilit Qeveria e Republikës së Kosovës pajtohet që Kuvendit, në pajtim me procedurat, t'i procedojë kandidaturat e propozuara nga Paneli Seleksionues për përzgjedhjen e anëtarëve jo ekzekutivë të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Me vendimin e aprovuar nga kabineti qeveritar në mbledhjen e sotme, janë aprovuar kriteret për financim të projekteve të komunave nga programi "Për pajisje të teknologjisë informative, avancimi i sistemeve dhe mirëmbajtja".

Kabineti qeveritar ka miratuar vendimin përfundimtar për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga ndërtimi i Rrugës regjionale Osojan-Rakosh në Komunën e Istogut.

Qeveria ka miratuar nismën për lidhjen e Marrëveshjes ndërkombëtare për eliminimin e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në tatimin në të hyra dhe kapital, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi.

Pas shqyrtimit nga kabineti qeveritar është miratuar Koncepti dokumenti për përmirësimin dhe avancimin e legjislacionit nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë. Ky Koncept dokument adreson çështjet e mosrregullimit të mjaftueshëm të bazës ligjore të fushës së sigurisë dhe shëndetit në punë. Sipas tij, duhet definuar përgjegjësitë e përndhënësve në rastet e aksidenteve në punë,

mbulueshmëria e punëtorëve pa kontrata të punës në rastet e aksidenteve në punë, rregullimi i përgjegjësive dhe obligimeve në rastet e sëmundjeve profesionale me mekanizmat mbikëqyrës, si dhe hartimin dhe raportimin e aksidenteve dhe të sëmundjeve profesionale në punë.

Me vendimin e miratuar nga qeveria, Rozafa Ukimeraj, sekretare e përgjithshme në Ministrinë e Pushtetit Lokal, për interes të institucionit, transferohet për gjashtë muaj në pozitën e sekretares së përgjithshme në Ministrinë e Mbrojtjes. Ky transferim bëhet me qëllim të kryerjes së të gjitha detyrave dhe përgjegjësive në bazë të legjislacionit në fuqi, brenda mandatit të saj.

Qeveria në këtë mbledhje është informuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë edhe me zbatimin e Ligjit për Investime Strategjike. Nga muaji shkurt i vitit 2018 deri në muajin nëntor 2020, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë janë pranuar 35 kërkesa për statusin e investitorit strategjik. Prej tyre 21 aplikime janë në fushën e sektorit energjetik, 7 në fushën e turizmit, 1 në sektorin e transportit dhe telekomunikacionit, 1 në sektorin e shëndetësisë dhe 5 në sektorin e bujqësisë dhe ushqimit.

Në informatën e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë vlerësohet se procesi i zbatimit të Ligjit për Investime Strategjike është një proces kompleks dhe kërkon angazhim, seriozitet dhe përkushtim nga Qeveria e Republikës së Kosovës me qëllim që të akomodojë secilin aplikim për statusin e investitorit strategjik potencial në Republikën e Kosovës.

## Osmani: Moslejimi i anëtarësimit në Këshillin e Evropës përbën mohim të qasjes në drejtësi për qytetarët e Kosovës


PRISHTINË, 23 NËNTOR (ER)- Me rastin e 70-vjetorit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe njëherësh fillimit të Kryesisë gjermane të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, të hënën u.d. presidentja, Vjosa Osmani ka marrë pjesë në konferencën virtuale ndërkombëtare me rastin e 70-vjetorit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

U.d. presidentja Osmani ka përgëzuar Këshillin e Evropës - Zyra në Prishtinë dhe Ambasadën Gjermane në Prishtinë për këtë organizim, duke potencuar rëndësinë e

angazhimit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. "Me tendencat gjithnjë e më rritje për të vënë në pikëpyetje vetë themelet e kësaj Konvente, ngjarje dhe konferenca të tilla na ofrojnë një mundësi të shkëlqyeshme për të reflektuar mbi atë se sa larg kemi arritur dhe çfarë duhet të priorizojmë në rrugëtimin tonë tutje për ta garantuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut", ka thënë Osmani.

Sipas saj, është mirë që Konventa nuk ka mbetur e ngrirë në kohë, porse nëpërmjet praktikave gjyqësore të Gjykatës

Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka arritur t'i përshtatet rrethanave. "Edhe pse mbetet i pakontestueshëm fakti që kjo Konventë paraqet dokumentin më të rëndësishëm e më të suksesshëm deri me tash për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Evropë, është fatkeqësi që Kosovës nuk i lejohet anëtarësimi në Këshillin e Evropës. Në Kosovë, Konventa është e zbatueshme drejtpërdrejt me nenin 22 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës. Mirëpo, është vërtetë jo e drejtë që Kosova ende nuk është anëtarësuar në Këshillin e



Evropës, ngaqë një gjë e tillë përbën në vete shkelje të të drejtave të njeriut përmes

mohimit të të drejtës për qasje në drejtësi për qytetarët e Kosovës", ka theksuar Osmani.

# Partitë hapin fushatën për zgjedhjet në Podujevë

EPOKA E FATON DËRMAKU

**PODUJEVË, 23 NËNTOR-** Partitë politike kanë hapur të hënën fushatën zgjedhore për zgjedhjet që do të mbahen më 29 nëntor në Komunën e Podujevës. Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka ftuar qytetarët e Komunës së Podujevës ta votojë kandidatin Naim Fetahu me numër 10, pasi sipas tij, Podujeva është ndalur në kohë dhe përgjegjësia për këtë i takon LDK-së dhe dy kundërkandidatëve Shpejtim Bulliqi dhe Nexhmi Rudari. “Në Podujevë është ndalur koha. I keni tre shembuj se si qeverisin partitë politike, sot në vitin 2020. Podujevën, e cila ka mbetur në

keqmenaxhim e keqpërdorim të madh dhe korrupsion më të madhin në vend. Kemi pasur blerje të produkteve pesë herë më të larta se me çmimin e tregut. Në këtë kohë komuna jonë ka funksionuar pa drejtor të shëndetësisë dhe pa drejtor të shtëpisë së shëndetit”, ka thënë ai. Tutje Fetahu ka shpalosur programin e tij qeverisës duke potencuar që do t'i japë prioritet përmirësimit të kushteve për rininë, barazisë gjinore në qeverisje, kualitetit të stafit në arsim dhe do të ketë trajtim të dinjitetshëm për kategoritë e dala nga lufta. Edhe kandidati për kryetar të Podujevës nga Lëvizja Vetëvendosje, Shpejtim Bulliqi, i cili mban numrin 12 në këto



hapësira kulturore, sportive e rekreative për të rinj, për

trotuar për shkak të cilave aksidentet rrugore janë të shpeshta e madje edhe tragjike”, ka thënë ai.

Sipas tij, me qeverisjes e Lëvizjes Vetëvendosje në Podujevë punësimet do të bëhen në baza profesionale, e jo në baza partiake e familjare siç janë bërë deri më sot.

Në këtë kontekst, ai ka thënë se do të kujdeset që procesi i aplikimit e konkurrimit të jetë sa më transparent, duke i publikuar konkurset për punësimet në komunë edhe në faqen e tij.

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Alibin Kurti, ka thënë se Podujeva kërkon një kryetar të jashtëzakonshëm siç është Shpejtim Bulliqi. “Këto zgjedhje të jashtëzakonshme, kërkojnë një subjekt të jashtëzakonshëm

si Lëvizja Vetëvendosje! dhe një kandidat të jashtëzakonshëm si profesori Shpejtim Bulliqi”, ka thënë Kurti.

Po ashtu edhe kandidati i LDK-së që në këto zgjedhje mban numrin 11, Nexhmi Rudari, ka hapur fushatën zgjedhore, ku ishte i pranishëm edhe Agim Veliu, ministër i Punëve të Brendshme.

Zgjedhjet në Podujevë mbahen pasi që kryetari i kësaj komune Agim Veliu u emërua në postin e ministrit të Brendshëm.

Rudari është shprehur i bindur në fitoren e tij, duke theksuar se Podujeva sërisht do të udhëhiqet si deri tani nga LDK-ja.

Zgjedhjet në këtë komunë ishin paraparë të mbahen më 15 mars, por për shkak të pandemisë Covid-19 ato u shtyn për 29 nëntor.



vend, Prizrenin ku qeverisë VV-ja dhe është një qeverisje e dështuar dhe Ferizajn ku qeverisë Partia Demokratike e Kosovës, e cila është një shembull se si qeveriset në nivelin lokal. Prandaj e ftoj çdo qytetar të Podujevës që kësaj here t'ia japë votën Naim Fetahut”, ka thënë Hoxhaj. Ai ka shtuar se vota për PDK-në është votë për një Kosovë dhe një Podujevë më të fortë. Kandidati i PDK-së për kryetar të Komunës së Podujevës, Naim Fetahu, ka thënë se me keqmenaxhimin dhe keqpërdorimin e qeverisjes 20 vjeçare të LDK-së, qyteti i Podujevës ka mbetur i pazhvilluar. “Sidomos gjatë pandemisë kemi pasur

zgjedhje, i shoqëruar edhe nga kryetari i kësaj lëvizje, Albin Kurti, kanë hapur të hënën fushatën zgjedhore në këtë komunë.

Me këtë rast, Bulliqi ka thënë se Llapi gjithmonë ka qenë në ballë të qëndresës e të çlirimit, kurse tani e tutje është koha që të jetë edhe në ballë të zhvillimit. “Fitorja e jonë dhe juaja përmes Lëvizjes Vetëvendosje do të jetë pikërisht hapi i parë në atë drejtim”, ka thënë Bulliqi.

Ai ka folur për nevojat e Komunës së Podujevës dhe qytetarëve të saj. “Për projektet infrastrukturore që asnjëherë nuk u realizuan sado që shpesh herë janë premtuar nga qeverisja keqe e deritanishme. Për bibliotekën e qytetit, për

mungesën e një spitali të qytetit, për gjendjen e dobët në shkollë, për rrugët e punuara keq dhe pa



## Reçica synon avancimin e legjislacionit në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë



**PRISHTINË, 23 NËNTOR (ER)-** Në kuadër të masave për të rritur sigurinë dhe shëndetin në punë për të vendosur standardet ndërkombëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) dhe Direktivat e BE-së për Siguri dhe Shëndet në Punë, të hënën në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës është miratuar konceptdokumenti për

përmirësimin dhe avancimin e legjislacionit për siguri dhe shëndet në punë. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skender Reçica, ka theksuar se ky konceptdokument është bazuar në planin e punës së qeverisë dhe adreson sfidat me të cilat ballafaqohet vendi lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë, është

thënë në njoftimin e kësaj ministrie.

Ky konceptdokument do të adresojë sfidat e identifikuara dhe do të avancojë proceset si në vijim: Krijimi i vendeve më të sigurta të punës; Përgjegjësi më të qarta për punëdhënësit të cilat lidhen me SSHP; Rregullimi me ligj i sëmundjeve profesionale, do të thotë të ketë mbikëqyrje

shëndetësore, kontrolla mjekësore dhe definim të listës së sëmundjeve profesionale; si dhe Klasifikim i aksidenteve në punë. “Ky konceptdokument i hap rrugë Ligjit të ri për Siguri dhe Shëndet në Punë, i cili do të vë bazat për një siguri dhe shëndet më të mirë të të gjithë punonjësve në vend”, ka thënë ministri i MPMS-së, Skender Reçica.

# Aplikimi për Kartonin e Gjelbër, vetëm pas shtatorit 2021



Prishtinë, 23 nëntor- Numri i madh i veturave të paregjistruara është vetëm një nga problemet që Kosova duhet të zgjidhë para se të bëhet aplikimi për anëtarësim në Këshillin e Byrosë Evropiane që siguron Kartonin e Gjelbër, thotë Sami Mazreku ushtrues i detyrës së drejtorit ekzekutiv të Byrosë Kosovare të Sigurimit.

Për të zvogëluar numrin e veturave të paregjistruara, Mazreku thotë se në muajin nëntor ka filluar të zbatohet një rregullore për zbatimin e sistemit Bonus-Malus. Në bazë të kësaj rregulloreje, një shkallë më e lartë e tarifës do të aplikohet për drejtuesit e automjeteve që vonohen të sigurojnë veturën.

Numri i veturave të paregjistruara në Kosovë për vite vazhdon të jetë një sfidë e madhe për institucionet. Sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, numri i veturave të paregjistruara në territorin e Kosovës është rreth 150 mijë.

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti ka deklaruar se në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Kosovës në janar të vitit të ardhshëm do të fillojnë bisedat e nevojshme për ta bërë Kosovën pjesë të Kartanit të Gjelbër.

Ai ka thënë se do të bashkëpunojnë me institucionet relevante që të ulin numrin e veturave të paregjistruara.

Kartoni i Gjelbër vërteton se një automjet përfiton në mënyrë të mjaftueshme nga mbulimi i përgjegjësive nga sigurimi. Kështu, kur makina përfshihet në një aksident në territorin e një shteti ku vlen sistemi i Kartanit të Gjelbër, sigurimi mbulon koston (e lëndimit, dëmtimit, etj).

## Aplikimi vetëm pas datës 4 shtator, 2021

Megjithatë, Kosova këtë proces mund ta nisë vetëm brenda institucioneve duke bërë zgjidhjen

e problemeve të brendshme, por jo të bëjë aplikim, pasi që me marrëveshjen e nënshkruar në Uashington më 4 shtator, Kosova ka rënë dakord që të vendosë moratorium njëvjeçar mbi kërkesën për anëtarësim në organizata ndërkombëtare.

Ushtruesi i detyrës së drejtorit ekzekutiv të Byrosë Kosovare të Sigurimit, Sami Mazreku thotë për "Radion Evropa e Lirë" se Kosova duhet të plotësojë disa kushtet të brendshme para se të mendojë që të aplikojë në organizatat e ndryshme ndërkombëtare, siç edhe për Kartonin e Gjelbër. Njëra prej problemeve që duhet zgjidhur për t'u bërë pjesë e Kartanit të Gjelbër Mazreku thotë se është zvogëlimi i numrit të lartë të automjeteve të paregjistruara.

"Lista e automjeteve të paregjistruara që janë akumuluar ndër vite duhet të pastrohen. Ato lista që janë dy vjet e më shumë të largohen me ndonjë vendim apo udhëzim nga sistemi dhe pjesa e mbetur dy vjet e këndeje, përmes formave tjera të obligohen ose të udhëzohen të vazhdojnë regjistrimin e veturave ose të çregjistrohen", thotë Mazreku.

## Nga mbi 30 për qind në 5 për qind duhet ulur numri i veturave të paregjistruara

Si një prej parakushteve teknike për anëtarësimin e Kosovës në sistemin e Kartanit të Gjelbër, shton Mazreku, është që numri i veturave të paregjistruara të mos jetë më shumë se 5 për qind, ndërkohë që sipas tij, në Kosovë numri i veturave të paregjistruara është mbi 30 për qind.

Një problem tjetër që po ashtu paraqet problem në anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Byrosë Evropiane është fakti se Kosova nuk është shtet anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

Mazreku thotë pasi që Kosova nuk është në OKB, atëherë duhet gjetur mënyra tjera të anëtarësimi. Në

një marrëveshje të nënshkruar në korrik të këtij viti mes Bankës Qendrore të Kosovës, qeverisë dhe Byrosë Kosovare e Sigurimeve është paraparë të themelohet një grup punues i cili do të identifikojë problemet e brendshme që paraqesin pengesë në sigurimin e Kartanit të Gjelbër. "Radio Evropa e Lirë" ka kontaktuar me zyrtarë të BQK-së për t'u njoftuar më shumë rreth këtij procesi dhe problemeve tjera të identifikuar, por që nuk ka marrë përgjigje.

## Rregullore e re për zvogëlimin e numrit të veturave të paregjistruara

Në Kosovë nga muaji nëntor i këtij viti ka filluar të zbatohet një rregullore për zbatimin e sistemit Bonus - Malus. Sistemi Bonus-Malus, merr për bazë një histori njëvjeçare të aplikuesit për sigurim dhe në bazë të aksidenteve të shkaktuara ose jo gjatë kësaj periudhe kalkulon bonusin ose malusin.

Një person që nuk bënë aksident në komunikacion shpërblehet me ulje të shumës së pagesës për sigurimin e automjetit dhe hyn në kategorinë bonus, ndërsa ata që bëjnë aksidente paguajnë më shtrenjtë dhe hynë në kategorinë malus.

Në bazë të kësaj rregulloreje një shkallë më e lartë e primit (tarifë), do aplikohet edhe për drejtuesit e automjeteve të cilëve u skadon kontrata e sigurimit.

Ky sistem, sipas Sami Mazrekut nga Byroja Kosovare e Sigurimit do t'i shërbejë zvogëlimin të numrit të madh të veturave të paregjistruara. Sami Mazreku thotë se me këtë rregullore, qytetarëve për herë të parë u është mundësuar që dhjetë ditë para se të iu skadojë sigurimi ta rinovojnë kontratën dhe të fitojnë bonusin e vitit të ardhshëm. "Përveç kësaj i kemi lënë edhe dy javë më vonë, 15 ditë pasi i skadon regjistrimi, nëse dikush harron ta sigurojë, do të

thotë 25 ditë i ka në dispozicion në mënyrë që të fitojë bonuset që parashikohen në rregullore", tha Mazreku.

Sipas rregullores, pronari i automjetit nëse nuk e vazhdon regjistrimin e automjetit është i obliguar që brenda 30 ditëve ta bëjë çajmërimin e automjetit dhe t'i kthejë tabelat në Qendrën e Regjistrimit të Automjetit, ku ka qenë i regjistruar automjeti. Nëse një gjë e tillë nuk ndodh pas 30 ditëve, pason dënimi.

Aplikim i kësaj rregulloreje në këtë formë është mirëpritur edhe nga grupi i njohur me emrin "Marakli t'kerreve", që përfaqëson ngasësit e automjeteve.

Agan Hajdarhoxha nga ky grup thotë për "Radion Evropa e Lirë" se këtë rregullore me këto kushte e kishin kërkuar qysh moti, për shkak që t'i mundësohet Kosovës të bëhet pjesë e Kartanit të Gjelbër. "Krejt qëllimi ka qenë që të hiqen veturat e paregjistruara nga komunikacioni për shkak se rrezikojnë komunikacionin dhe po ashtu kanë rritur sigurimin e veturave", tha Hajdarhoxha.

## Kartoni i Gjelbër s'blidhet në Kosovë

Ndërkohë, qytetarët të cilët dëshirojnë të udhëtojnë në vende të ndryshme të Evropës, Kartoni i Gjelbër e sigurojnë në disa kompani transporti në Kosovë. Kjo mund të sigurohet në agjenci që janë të publikuara në rrjete sociale. "Radio Evropa e Lirë" ka kontaktuar me një person në një nga numrat e telefonit të publikuar në rrjetet sociale dhe ka treguar se në Kosovë mund të blidhet Kartoni i Gjelbër që është i vlefshëm për të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian, përveç Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut. Ai thotë se ky dokument është sigurim nga shteti i Bullgarisë. Për një muaj, ky dokument kushton 85 euro kurse për tre muaj 110 euro, me të cilin personat e

interesuar mund të pajisen brenda ditës.

Por, Mazreku pohon se askush nuk ka të drejtë ta shesë Karton të Gjelbër në territorin e Kosovës. Ai thotë se sigurimi nga shteti i Bullgarisë është i vlefshëm vetëm nëse blidhet në Bullgari, kurse askush nuk ka të drejtë ligjore që këtë dokument ta shesë në Kosovë. Ai thotë se nuk ka njohuri se në çfarë forme mund të blidhet ky dokument.

Edhe Banka Qendrore e Republikës së Kosovës vitin e kaluar ka thënë se shitja e Kartanit të Gjelbër është e paligjshme. "BQK-ja në rrjetet sociale ka vërejtur se disa persona, të paautorizuar dhe të palicencuar që ushtrojnë veprimtari ndërmjetësuese në sigurime në mënyrë të paligjshme, duke u angazhuar në shitjen e Kartanit të Gjelbër. Për më tepër, asnjë kompani sigurimi, e pajisur me licencë nga BQK-ja dhe asnjë person fizik apo juridik i jashtëm, nuk ka të drejtë të shesë një produkt të tillë në Kosovë, derisa Byroja Kosovare e Sigurimit të bëhet anëtare e Këshillit të Byrove, apo pa lejen e Këshillit të Byrove dhe BQK-së", ka thënë BQK-ja.

Kurse, deri tek anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Byrove të Evropës, të gjitha veturat me tabela të huaja, të cilat hynë në territorin e Kosovës, sipas ligjeve në fuqi, duhet të paguajnë një shumë për tarifën e sigurimeve shumë, varësisht nga lloji i automjetit dhe koha e qëndrimit në Kosovë.

Personat që hynë në Kosovë me auto-vetura duhet të paguajnë 15 euro për qëndrimin prej 15 ditësh. Ndërkaq, qëndrimi për një muaj kap vlerën e sigurimit prej 20 euro. Ndërkaq nga muaji gusht i këtij viti, Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për mbulimin e sigurimit kufitar për qytetarët e Kosovës që jetojnë dhe punojnë në shtete të ndryshme të Evropës dhe të huajt që hynë në territorin e Kosovës.

# Loci: Komuna e Pejës i ka ngritur në maksimum kapacitetet mjekësore për t'u përballur me Covidin

PEJË, 23 NËNTOR (ER)- Kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, ka mbajtur të hënën takim konsultativ të Këshillit të Drejtorëve, ku u diskutua për çështje të ndryshme. Gjatë takimit është diskutuar për menaxhimin e situatës për parandalimin e Covid-19 deri në normalizimin e gjendjes, reduktimin e stafit dhe për procesin e mësimin në këtë komunë.

Në këtë takim është bërë me dije se për shkak të rritjes së rasteve

me Covid në shkollat "Vaso Pashë Shkodrani" dhe "Shaban Spahija", mësimi në këto dy shkolla ende po vazhdon të mbahet online.

Gjithashtu në këtë takim është kërkuar që aktivitetet e prokurimit të përmbillen në afatin optimal për këtë vit.

Drejtori për Shëndetësi në Komunën e Pejës, Petrit Loci, ka thënë se nëse vazhdon kjo gjendje me rritje të rasteve me Covid, atëherë duhet të bëhen gati edhe QMF-ja në Taphane si



ndihmë e QMF-së në Fidanishte për trajtimin e rasteve me Covid për dhënie të terapive. Ai ka thënë se komuna i ka ngritur në maksimum kapacitetet mjekësore për t'u përballur me Covidin, përkundër vështirësive, të cilat, po paraqiten, sidomos me sigurimin e listës esenciale. Aktualisht në spitalin e përgjithshëm në Pejë janë të shtrirë 124 pacientë me Covid-19 ku gravitojnë pesë komuna të këtij regjioni.

## I jepet lamtumira këngëtarit Ismet Peja

GIJAKOVË, 23 NËNTOR (ER)- Të hënën në varrezat e qytetit të Gjakovës i është dhënë lamtumira e fundit këngëtarit, 83-vjeçar, Ismet Peja. Ngushëllime familjes Peja i kanë shprehur përfaqësues të Komunës së Gjakovës, përfaqësues të komunitetit artistik dhe përfaqësues të nivelit qendror.

Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, në telegramin ngushëllues ka thënë se me dhimbje të madhe ka marrë lajmin për ndarjen nga jeta të doajenit të muzikës, këngëtarit me muzikën e të cilit është rritur, bilbilin të Gjakovës, Ismet Peja. "Kemi humbur një njeri e një artist të papërsëritshëm. Ismet Peja ishte dhe do të mbetet emër i pashlyeshëm i kulturës dhe artit shqiptar", ka thënë Dumoshi.

Ndërkaq kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, i shoqëruar edhe nga ministrja Dumoshi ka bërë homazhe në nderim të jetës dhe veprës të ikonës së muzikës së



mirëfilltë shqipe, Ismet Peja. "Këngëtarit Ismet Peja ka hyrë në historinë artistike të Kosovës. Ne të gjithë jemi rritur me këngët e tij, sot vërtet është ditë e dhimbshme për familjen e komunitetin artistik. Por ne

do ta kujtojmë gjithmonë më këngët e tij", ka thënë Hoti. Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, kryeministri Hoti shprehu ngushëllimet më të sinqerta për familjen, miqtë dhe komunitetin artistik.

## Shpërndahen makineritë për prodhimin e mobilieve për përfituesit nga Fondi i Punësimit

FERIZAJ, 23 NËNTOR (ER)- Në kuadër të Fondit të Punësimit, janë dhjetëra biznese ferizajase që kanë përfituar nga faza të ndryshme të mbështetjes me makineri e pajisje për biznese. Të hënën u shpërndanë makineritë e pajisjet për pesë përfituesit nga faza e parë për makineri për prodhimin e mobilieve, ku i pranishëm në shpërndarje

ishte edhe drejtori i Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Zekir Bytyçi.

Ai ka thënë se me këtë po dëshmohet mbështetja për bizneset nga qeveria lokale dhe se si e tillë kjo mbështetje do të vazhdojë, derisa ka paralajmëruar edhe shpalljen e rezultateve, ditëve në vijim, të përfituesve nga faza e dytë e thirrjes publike.



## Komuna e Mitrovicës nuk do t'i dekorojë sheshet e qytetit për festat e fundvitit

MITROVICË, 23 NËNTOR (ER)- Drejtuar nga nënkryetari i komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, të hënën është mbajtur mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve, ku janë diskutuar dhe shqyrtuar çështje të rëndësishme nga fushëveprimi i Bordit, që janë në interes për qytetarët e Mitrovicës.

Fillimisht drejtori i Arsimit, Ismet Ferizi, ka njoftuar ekzekutivin lidhur me rekomandimin e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike për mbylljen e çerdhes publike "Gëzimi Ynë", SHFMU "Eqrem Qabej", SHMLT "Arkitekt Sinani" si dhe

shkollën e muzikës "Tefta Tashko" pas rasteve të konfirmuara pozitiv me virusin Covid-19 të disa mësimdhënësve dhe nxënësve, ku nga IKShPK-ja është kërkuar vetizolimi i stafit dhe nxënësve për 14 ditë, si dhe dezinfektimi i tërë objektit të çerdhes.

Me këtë rast, drejtori Ferizi ka bërë me dije se këto shkolla do të vazhdojnë mësimin online, sipas skenarit 'C' të përcaktuar nga Ministria e Arsimit.

Po ashtu në këtë mbledhje nënkryetari Mujka ka thënë se për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia Covid-19, këtë vit nuk do të dekorohen

sheshet e qytetit të Mitrovicës, pasi që prioritet i komunës është shëndeti i qytetarëve dhe mbështetja e familjeve me gjëra ushqimore apo mjekësore që jetojnë në kushte jo të mira ekonomike. Gjithashtu lidhur me vendimin e MSh-së që vendosi Mitrovicën në zonën e kuqe, nënkryetari Mujka ka kërkuar nga qytetarët të respektojnë masat në fuqi, si dhe t'u shmangen ambienteve të mbyllura, pasi që këto ditë numri i të infektuarve në këtë qytet ka qenë më i madh. "Si pasojë e kësaj jemi futur në zonë të kuqe. Andaj bashkërisht duhet të



tregohemi vigjilent dhe të kujdesshëm, sepse ne po detyrohemi t'i mbyllim institucionet relevante siç janë

shkollat dhe çerdhet, me qëllimin e vetëm për të ruajtur shëndetin e fëmijëve tanë", ka thënë Mujka.

# SHQIPËRIA DHE MAQEDONIA E VERIUT SFIDOHEN SËRISH NË BE



**Prof. Lisen BASHKURTI**

Muaji nëntor 2020 shënoi sfidat e radhës për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut me Bashkimin Evropian. Të dy vendet po përpëliten në mënyrë mjerane për të bindur Bashkimin Evropian, respektivisht të gjitha vendet anëtare për të organizuar konferencat ndërqeveritare për hapjen e negociatave për anëtarësim. Por, mjerisht, edhe muaji nëntor nuk hapi dritë të jeshile as për Shqipërinë dhe as për Maqedoninë e Veriut. Në mars 2020, liderët e BE-së hapën për të dyja vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut shpresat për të filluar bisedimet formale për t'iu bashkuar bllokut të BE-së. Çfarë po ndodh me këto dy vende dhe çfarë po ndodh brenda BE-së lidhur me Ballkanin Perëndimor?

## 1. Shqipëria, dështim i brendshëm, mbuluar me pluhur propagandë

Shqipëria po ecën në rrugën e dështimit për organizimin e konferencës ndërqeveritare për hapjen e negociatave me BE-në. Një numër kërkesash të përsëritura në mënyrë insistuese po i vendosen këtij vendi nga BE-ja dhe nga vende anëtare të veçanta. Kohët e fundit, duke parë që kapaciteti i Shqipërisë për të realizuar 15 kërkesat e Bundestagut Gjerman të vitit e kaluar, kërkesa që u shndërruan në kushte të BE-së për organizimin e konferencës së parë ndërqeveritare Shqipëri-BE për hapjen e negociatave për anëtarësim, janë të kufizuara, BE-ja i reduktoi këto kërkesa në dy: së pari, në funksionalizimin e Gjykatës Kushtetuese brenda vitit; së dyti, në rishikimin e ligjit me mediet.

Deri tani, në Shqipëri, në vend që të ecet në këto dy drejtime, Qeveria Rama po përpiqet që ta mbulojë këtë dështim të radhës me pluhur propagande që synon të largojë vëmendjen e politikës, medias dhe të opinionit publik mbi këtë dështim fatal. Propaganda e Qeverisë Rama është shumëfishuar dhe përkeqësuar aq shumë saqë edhe vetë krijuesit e saj kanë filluar të mos e besojnë më. Dështimi në rrugën drejt BE-së duhej të ishte këmbanë alarmi

për politikën, medien dhe opinionin publik për arsye se cenon aspiratën më ambicioze të popullit shqiptar tash 30 vjet. Në fakt, pluhuri i propagandës së harresës ishte kaq i madh dhe kaq i nxirë saqë, as politika, as opinionin publik dhe as media nuk i ranë këmbanave të alarmit. E fokusuar në debatin politik të ditës, e mbërthyer nga Covid-19 dhe kriza e rëndë ekonomike dhe sociale Qeveria, politika, media dhe opinion publik po lënë në hije problemin më madhor: dështimin në rrugën drejt BE.

## 2. Maqedonia e Veriut, historia po përsëritet me Bullgarinë

U bënë një dekadë e gjysmë qëkur Maqedonia e Veriut ka aplikuar për anëtarësim në BE e sërish vendi po sfidohet në këtë rrugë. Mbas afro dy dekadash debate të zjarra bllokuese në BE me fqinjën e Jugut, Greqinë lidhur me emrin, të dy palët arritën një marrëveshje, që u konsiderua historike nga palët. Vendi i riemërua 'Maqedonia e Veriut', që i hapi dritën e jeshile për në BE. Por, kur çdo gjë dukej se po ecte mbarë për Maqedoninë e Veriut, një tjetër sfidë iu shfaq në horizont, këtë radhë nga fqinji Lindor, Bullgaria.

Bullgaria, tanimë e përfshirë në protesta të mëdha antiqeveritare, ka kundërshtuar hapjen e bisedimeve për anëtarësim me Maqedoninë e Veriut, duke u deklaruar se është e "pakënaqur nga kuadri aktual i negociatave". Sipas shtypit të BE-së, ministri i jashtëm bullgar nuk ka dhënë ndonjë shkak specifik për këtë kundërshtim, por thjeshtë është shprehur se kuadri aktual i negociatave "nuk parashikon garancitë ligjore të kërkuara nga Bullgaria", duke shtuar më tej se kërkesat e tij janë bashkëngjitur formalisht në dokumentet e negociatave.

Dy kërkesat e Bullgarisë ndaj Maqedonisë së Veriut lidhen direkt me çështje të identitetit të kësaj të fundit. Së pari, është çështja e identifikimit të gjuhës së Maqedonisë së Veriut. Bullgaria kërkon që gjuha e Maqedonisë së Veriut të identifikohet si gjuhë bullgare ose idealet e saj, duke mohuar ekzistencën e një gjuhë të veçantë maqedone. Maqedonia e Veriut e kundërshton diçka të tillë, duke i quajtur dy gjuhë të veçanta që kanë nevojë për interpretim dhe përkthim, ndryshe nga rasti i Serbishtes dhe Kroatishtes, që janë të një trangu dhe nuk kanë nevojë për

interpretim dhe përkthim. Së dyti, kërkesa e tjetër e Bullgarisë lidhet me definimin e identifikimin e vetë identitetit 'Maqedonas'. Bullgaria zyrtare dëshiron që të njihet 'origjina Bullgare e kombit Maqedonas', dhe të hiqet dorë nga pala e Maqedonisë së Veriut prej çdo lloj pretendimi që 'minoriteti maqedonas në Bullgari të thërritet si 'Maqedonas', por vetëm si 'Bullgarë'.

Bazuar në studimet e bëra nga 'Instituti Ndërkombëtar për Studime për Lindjen e Mesme dhe Ballkanike' (the International Institute for Middle East and Balkan Studies (IFIMES), Maqedonasit etnik përbëjnë 10 për qind të popullsisë së Bullgarisë'. Gjithashtu, po ky institut vëren se 'gjuhët Bullgare dhe Maqedone janë dy gjuhë të ndryshme për të cilat komunikimi ka nevojë për interpretim dhe përkthim dhe jo si në rastin e serbishtes dhe kroatishtes, komunikimi ndërmjet të cilave nuk ka nevojë për interpretim dhe përkthim'. Qasja e fortë nacionaliste e Bullgarisë ndaj Maqedonisë së Veriut, duke atakuar dy kolonat themelore të identitetit kombëtar të saj, identitetin kombëtar dhe gjuhën lidhet me së shumti me situatat politike të brendshme që po kalon aktualisht qeveria e Bullgarisë. Situata jo e rehatshme për Qeverinë Bullgare, që po përballet prej 100 ditësh me protesta të fuqishme popullore kundër korrupsionit dhe me mocione mosbesimi në Parlament po e shpie Bullgarinë drejt një qasje nacionaliste të përafërt me atë të kryeministrit hungarez, Viktor Orban. Protesta Bullgare kanë targetuar kryeministrin Borisov dhe kryeprokurorin Geshev si të

lidhur me oligarkinë mafioze. Borisov ka refuzuar të dorëhiqet dhe deri tani i ka mbijetuar mocioneve mosbesimit.

Për konjunkturën e vështirë të Bullgarisë, procesi i pranimit të Maqedonisë së Veriut në BE është mënyra më e mirë për të detyruar Shkupin që të bëjë koncesione esenciale ndaj Bullgarisë. Akoma më e rëndësishme është fakti që këto koncesione kërkojnë për çështje identitare dhe historike, duke reflektuar nevojën e Qeverisë Bullgare për të adoptuar një qasje të fortë nacionaliste për arsye të mirëfillta politike të brendshme. Sidomos në kushtet e përbaljes me përfolje për korrupsion, protesta rrugëve të Bullgarisë dhe rënia ekonomike për shkak të pandemisë që ka prekur vendin.

## 3. BE-ja, imazh i cenuar në Ballkanin Perëndimor

I kapluar nga sfidat e brendshme që nga kriza financiare e 2008, valët emigrative pas 'pranverës arabe', brexi-ti britanik dhe nacional-populizmat anë e kënd hapësirës politike brenda dhe jashtë tij, Bashkimi Evropian është i detyruar të përballet edhe me sfidat e zgjerimit. Këtë radhë sfidat e zgjerimit lidhen me Ballkanin Perëndimor. Me përjashtim të Kroacisë, që e kaloi këtë sfidë pa kokëçarje të mëdha për BE, vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor duket se po paraqesin sfida të shumta dhe të vazhdueshme.

Një nga sfidat aktuale të BE duket të jetë ngjallja e qasjeve nacional-populiste që cenojnë shtetin ligjor, mirëqeverisjen dhe politikën e jashtme të BE-së lidhur me zgjerimin. Pas shqetësimeve të BE lidhur me modelin e Orbanit në Hungari, edhe Bullgaria, këtë radhë si një

vend direkt i lidhur me Ballkanin Perëndimor, po cënon politikën e zgjerimit. Për BE-në është principale që vendet anëtare të respektojnë demokracinë, sundimit e ligjit dhe politikën e unifikuar të BE-së për zgjerimin drejt Ballkanit Perëndimor. Lufta kundër krimit dhe korrupsionit janë targete në ngritje në BE. Kultura e ndëshkimit kundër tyre, gjithashtu. Hungaria dhe Bullgari duket se përbëjnë shqetësim për BE në këto aspekte të demokracisë, sundimit të ligjit, luftës kundër krimit dhe korrupsionit dhe adoptimit të politikave në linja të unifikuar me BE për zgjerimin. Qasja e fundit e Bullgarisë ndaj Maqedonisë së Veriut tregon një krisje tjetër brenda BE-së për politikën e zgjerimit ndaj Ballkanit Perëndimor. Ky incident paraqet një sinjal të rëndë dhe shumë të komplikuar që mund ta shndërrojë politikën e zgjerimit të BE-së drejt Ballkanit Perëndimor, nga instrumenti më efikas i politikës së jashtme të BE-së, në një instrument të dobët dhe aspak efektiv. Një devijim i tillë i qëllimit dhe funksionimit të politikës së zgjerimit të BE-së drejt Ballkanit Perëndimor do të dëshmonte qartazi ndërkombëtarisht se BE-ja sa më shumë që zgjerohet dhe diversifikohet, aq më shumë bëhet e pamundur për të adoptuar dhe aplikuar politika të përbashkëta dhe norma të politikës së saj të jashtme pa u përballur me agjenda nacionaliste që e sfidojnë brenda saj. Nuk ka asnjë dyshim se devijime të tilla nacional-populiste nga vlerat, politikën dhe normat e BE-së e dëmtojnë rëndë imazhin e BE-së në rajonin e Ballkanit Perëndimor, i cili pret nga BE-ja ta mbajë premtimin e bërë për zgjerim.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## 'Dardanët' shkojnë në Bratislavë, synohen rezultatet pozitive

"Ne jemi optimistë se nga Bratislava do të kthehemi kokëllartë dhe se djemtë tanë do të na bëjnë krenarë edhe një herë", ka thënë Granit Rugova, drejtor i përfaqësuesve të Kosovës



gjithëve. Sidoqoftë, ne jemi optimistë se nga Bratislava do të kthehemi kokëllartë dhe se djemtë tanë do të na bëjnë krenarë edhe një herë", ka thënë Rugova. Kosova do të përballet me Sllovakinë më 26 nëntor, derisa dy ditë më vonë (28 nëntor) përballet me Islandën. "Dardanët" janë lider të grupit, ku në muajin shkurt të këtij viti, shënuan fitore ndaj Islandës dhe Luksemburgut.

**PRISHTINË, 23 NËNTOR** - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll të hënën ka mbërritur në Bratislavë të Sllovakisë në "Bubble" të Dritares së Dytë të parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2023. "Dardanët" stërvitet do t'i zhvillojë nga data 24 nëntor, në ditën në të cilën të gjithë delegacioni do të testohet për herë të tretë, pas dy herëve që janë testuar në Prishtinë më 16 dhe 21 nëntor, gjithnjë duke u bazuar në protokollin e FIBA-s për Covid-19. "I kemi bërë të

gjitha përgatitjet e duhura për tu nisur për në Bratislavë. Sa i përket testeve, i kemi kryer dy teste në Prishtinë dhe tani na pret edhe një test nga FIBA në datën 24 nëntor. Ne do të udhëtojmë të hendikepuar pa Dardan Berishën dhe disa lojtarë të tjerë, por basketbollistët që kanë qëndruar në karantinë nga dita e mërkurë e kanë dhënë maksimumin në stërvitje dhe në bashku me trajnerin Marmarinos kemi punuar shumë me ta, edhe në aspektin

mental në mënyrë që ata të jenë sa më të gatshëm për të gjitha sfidat që na presin në Bratislavë", ka thënë Granit Rugova, drejtor i përfaqësuesve të Kosovës. "Bëhet fjalë për dy kundërshtarë shumë të fortë, pra Sllovakinë dhe Islandën, por ne premtojmë se do ta japim maksimumin në parket gjë të

cilën e kanë premtuar djemtë tanë që nga dita e parë, që kemi hyrë në karantinë. Duke u nisur nga fakti se bëhet fjalë për pandeminë Covid-19, ne shpresojmë se edhe në këtë aspekt do të kalojmë mirë dhe nuk do të kemi ndonjë problem sa i përket kësaj pandemie, e cila na ka shkaktuar telashe të

### LISTA E BASKETBOLLISTËVE

Drilon Hajrizi (kapiten), Edmond Azemi, Alban Veseli, Altin Morina, Arian Qallaku, Musab Mala, Mikaile Tmusiq, Urim Zenelaj, Leonard Mekaj, Erjon Kastrati, Fisnik Rugova, Valon Bunjaku, Meriton Ismaili

## PSG-ja kërkon hakmarrje ndaj Leipzigit



**PARIS, 23 NËNTOR (ER)** - Paris Saint Germain në fillim të muajit pësoi humbje në "Red Bull Arena Leipzig" nga Leipzig (2-1), kurse sonte (e martë) kërkon hakmarrje kundër klubit gjerman dhe të njëjtën kohë dëshiron të ruaj shpresat për kualifikim në fazën tjetër. Kampionët në fuqi të Francës aktualisht janë në vendin e tretë

në Grupin H, me tri pikë me pak se Unitedi dhe Leipzig dhe me një fitore do të rriste gjasat e kalimit tutje. Në anën tjetër skuadrës gjermane do t'i mjaftonte edhe barazimi, pasi do të ishin në epërsi ndaj PSG-së nga përballjet direkte. Në ndeshjen tjetër të këtij grupi, Manchester United e pret në "Old Trafford", Istanbul

Basaksehir dhe pret edhe tri pikë të reja. Ndeshje interesante do të zhvillohen edhe në Grupin F ku tri klube janë në garë për kualifikim. Borussia Dortmund që kryeson grupin e pret Club Brugge dhe me një fitore do të ishte me një këmbë në raundin tjetër, derisa Lazio e Vedat Muriqit e pret Zenitin me synim që të marrë maksimumin e pikëve dhe

GRUPI E			GRUPI G		
18:55 Krasnodar - Sevilla 18:55 Rennes - Chelsea			21:00 Dynamo Kyiv - Barcelona 21:00 Juventus - Ferencvaros		
Tabela			Tabela		
		PIKË			PIKË
1. Chelsea	3	7	1. Barcelona	3	9
2. Sevilla	3	7	2. Juventus	3	6
3. Krasnodar	3	1	3. Dynamo Kyiv	3	1
4. Rennes	3	1	4. Ferencvaros	3	1
GRUPI F			GRUPI H		
21:00 B.Dortmund - Club Brugge 21:00 Lazio - Zenit			21:00 Manchester United - Istanbul B. 21:00 PSG - Leipzig		
Tabela			Tabela		
		PIKË			PIKË
1. Dortmund	3	6	1. United	3	6
2. Lazio	3	5	2. Leipzig	3	6
3. Club Brugge	3	4	3. PSG	3	3
4. Zenit	3	1	4. Istanbul B.	3	3

të përforcohet në pozitën e dytë. Në Grupin A, Chelsea dhe Sevilla që kryesojnë me nga 7 pikë, presin fitoret e radhës ndaj Krasnodarit, përkatësisht Reensit. Në Grupin G, Barcelona që pësoi

humbje në ndeshjen ndaj Atletico Madridit në La Liga kërkon fitore ndaj Dynamo Kyiv për të ruajtur pozitën e parë. Fitore synon edhe skuadra e Juventusit në përballje me Ferencvaros.

## Sot zhvillohen dy ndeshje në Superligë

Prishtinë, 23 nëntor - Superliga e Kosovës në futboll do të vazhdojë në mesjavë me xhiron e 14-të. Dy ndeshje do të zhvillohen sot (e martë), ku spikat derbi në mes kampionës në fuqi të elitës, Dritës dhe skuadrës së Feronikelit. Skuadra gjilanase kërkon

fitoren e radhës në mënyrë që të mbesë në hap me skuadrën e Ballkanit, derisa "Nikli" synon rezultat pozitiv në Gjilan. Sot zhvillohet edhe ndeshja tjetër në mes Arbërisë dhe Gjilanit. Nesër (e mërkurë) Llapi e pret Prishtinën. Dy skuadrat në radhët e tyre kanë

futbollistë cilësor, por kanë ambicie të kundërta në këtë edicion, pasi Llapi është në pozitën e parafundit dhe Prishtina është në pjesën e sipërme. Ndeshja tjetër është në mes Trepçës '89 dhe Besës, derisa të enjten takohen Drenica dhe Ballkani.



### SUPERLIGA

**Të martën takohen:**  
13:00 Drita - Feronikeli  
13:00 Arbëria - Gjilani

**Të mërkurën takohen:**  
13:00 Llapi - Prishtina  
13:00 Trepça '89 - Besa

**Të enjten takohen:**  
13:00 Drenica - Ballkani

## Reja: Ibra më i kompletuar se Ronaldo

TIRANË, 23 NËNTOR - Trajneri i Shqipërisë, Edoardo Reja, e ka lartësuar sulmuesin e Milanit, Zlatan Ibrahimoviç, duke thënë se suedezi është më i kompletuar se sulmuesi i Juventusit, Cristiano Ronaldo. Ibrahimoviç i shënoi dy gola

në fitoren e Milanit 3-1 kundër Napolit, falë të cilës kuqezinjtë janë në krye të renditjes. "Ardhja e Ibrahimoviçit ka qenë vendimtare për Milanin, por edhe Pioli ka formuar një skuadër të fortë. Gjiganti suedez është shndërruar në

njeriun simbol të skuadrës që luan shumë mirë futboll. Kur humbin topin, ata vrapojnë me shumë këmbëngulje, për ta rikuperuar menjëherë. Kanë organikën e duhur për të arritur zonën Champions, ndonëse do të ishte mirë t'i

shtohet edhe pak cilësi", ka deklaruar Reja. "Ibra ka fituar shumë eksperiencë dhe për më tepër tani nuk është më egoist si më parë. Tani luan më shumë për skuadrën, por në aspektin karakterial. Ronaldo për shembull është një lojtar



më individual, Ibra është më të vërtetë i plotë", ka shtuar Reja.

## Qallaku: Për rezultate pozitive ndaj Sllovakisë dhe Islandës

PRISHTINË, 23 NËNTOR - Basketbollistët e Kosovës nga dita e mërkurë deri të dielën kanë stërvitur së bashku, derisa të hënën kanë udhëtuar drejt Bratislavës, ku do të përballen me Sllovakinë dhe Islandën. Këto dy ndeshje zhvillohen në kuadër të parakualifikimeve evropiane për Kupën e Botës 2023. Një nga lojtarët më të dalluar të Sigal Prishtinës në Superkupë dhe në ndeshjet e Prince Caffè Superligës ka qenë Arian Qallaku. Ai është i lumtur që tani i ka ardhur ftesa nga Kosova.

"Ftesën nga Kosova e kam pritur me shumë pozitivitet, për arsye se, do të përfaqësoj shtetin tim dhe për këtë arsye jam shumë i lumtur. Jam i nderuar që përfaqësoj vendin tim në garat ndërkombëtare. Kjo do të thotë shumë për mua", ka thënë Qallaku për faqen zyrtare të FBK-së. Ai ka folur edhe për rrjedhën e përgatitjes. "Përgatitjet kanë duke shkuar shumë mirë dhe të gjithë lojtarët e kanë dhënë maksimumin në çdo stërvitje.



Atmosfera në ekipin e Kosovës ka qenë shumë e mirë për këto ditë sa kemi qenë së bashku", ka shtuar tutje Qallaku.

Ariani flet edhe për sfidat ndaj Sllovakisë dhe Islandës. "Mendoj se do të paraqitemi në mënyrën më të mirë të mundshme në të dy ndeshjet që do t'i luajmë. Shpresojmë të nxjerrim rezultat pozitiv. Angazhimi ynë nuk do të

mungoj dhe besoj që çdo basketbollist që do të paraqitet në parket do të jap më të mirën e tij", ka shtuar Qallaku. Kosova më 26 Nëntor do të ballafaqohet me Sllovakinë, kurse më 28 Nëntor do të përballen me Islandën. "Dardanët" janë liderë të grupit me dy fitore në dy ndeshje. Kosova ka shënuar fitore ndaj Islandës 80:78 dhe Luksemburgut 80:84.

## Shevchenko dhe Figueiredo mbrojnë titujt kampionë

Las Vegas, 23 nëntor - Në Las Vegas (Amerikë) u zhvillua event i UFC-255, ku ishin dy duele për titullin kampion bote në peshën "yweight" (pesha 53-57kg). Për femra, Valentina Shevchenko (peruanian me origjinë ruse) fitoi me vendim unanimit gjyqtarëve ndaj Jennifer Maia. 49-46, 49-46 ishte vendimi i tre gjyqtarëve në favor të Shevchenko, mbrojtja për të katërtën herë titullin e këtij Divizioni. Për Shevchenkon ky ishte triumfi numër 20 në karrierën e saj (i gjashti radhazi), ku numëron edhe 3 humbje, ndërsa për Maia kjo ishte humbja e 7-të (numëron edhe 18 tore e 1 duel pa rezultat). Te meshkujt, Deiveson Figueiredo, mposhti me "submission" rivalin Alex Perez, duke mbrojtur titullin e peshës "yweight". Një duel që nuk pati



histori, pasi Figueiredo u tregua i shkathët që në momentet e para, duke hedhur KO rivalin e tij. Ky është suksesi i 20-të i Figueiredo

në karrierë, ku ka edhe 1 humbje, ndërsa për Perez kjo ishte humbja e 6-të, ndërkohë që ka arritur edhe 24 fitore.

### SHKURT

#### Shaqiri mungon ndaj Atalantës

Futbollisti shqiptar i Kombëtares së Zvicrës, Xherdan Shaqiri është futbollisti i radhës që i ka munguar Liverpoolit në ndeshjen e fundit shkak i një lëndimi të pësuar. Lajmi është konfirmuar edhe nga trajneri Jurgen Klopp, që ka njoftuar se Shaqiri ka pasur probleme me muskujt e këmbës. "Shaqiri kishte një problem me muskujt gjatë kohës sa ishte me ekipin kombëtar, por ai nuk e kishte kuptuar as vetë se ishte lënduar. Ai u rikthye në klub, stërviti me ne dhe më vonë e ndjeu. Pasi i bëmë një skanim e kuptuam se bëhej fjalë për një lëndim që i kishte ndodhur pesë ose gjashtë ditë më herët", deklaroi Klopp. Shaqiri do të mungojë edhe të mërkurën mbërma në ndeshjen e Ligës së Kampionëve ndaj Atalantës

#### Ronaldo synon të qëndrojë edhe një vit te Juve

Ardhja e trajnerit Andrea Pirlo në krye të Juventusit raportohet se e ka bindur Cristiano Ronaldo-n që të japë edhe më shumë për Juventusin, si dhe portugezi po synon të vazhdojë qëndrimin e tij te "Zonja e Vjetër" deri në verën e vitit 2022. "TuttoSport" shkruan se Pirlo ka lënë përshtypje të mirë te ylli portugez që nga dita e arë kur erdhi në "Allianz Arena" dhe ai dëshiron që ta ndihmojë ish-mesfushorin e Italisë që të fitojë në vitin e tij të parë si trajner. Ronaldo po kalon nëpër një formë shumë të mirë në këtë edicion ku ka realizuar tetë gola në pesë ndeshje dhe është i bindur që ta vazhdojë kontratën me Juventusin deri në muajin qershor të vitit 2022.

#### Dzeko shërohet nga Covidi

AS Roma mori një lajm mjaft të mirë, pasi sulmuesi Edin Dzeko e ka kaluar Covidin. Sulmuesi boshnjak ka njoftuar se më në fund ka rezultuar negativ. Klubi nga kryeqyteti italian është në pritje të rikthimit të shqiptarit Marash Kumbulla, i cili që 14 ditë ka rezultuar pozitiv me Covid-19.

#### Salahi mposhti koronavirusin

Muhamed Salah ka rezultuar negative në tamponin e fundit dhe nga sot mund të stërvitet me skuadrën, për të qenë gati për sfidën e të mërkurës në Ligën e Kampionëve, përballë italianëve të Atalantës. Ylli egjiptian i futbollit u prek nga koronavirusi disa ditë më parë, teksa kishte marrë pjesë në ceremoninë martesore të vëllait të tij, veprim që u kritikua jo pak nga mediat sportive në Britaninë e Madhe. Megjithatë Salah u mor në mbrojtje nga trajneri Klopp dhe tani është shëruar plotësisht, ndaj që nga mesjava do të kërkojë t'u përgjigjet kritikave në fushën e lojës. Një tjetër lajm i mirë për teknikun gjerman është edhe rikuperimi i brazilianit Fabinho, i cili edhe mbrëmë luajti titullar në qendër të mbrojtjes.

## Futbollisti afrikan vdes në aksident automobilistik

Ish-futbollisti i kombëtares së Afrikës së Jugut, Anele Ngcongca vdiq tragjikisht mëngjesin e sotëm në një

aksident automobilistik në qytetin e Durbanit. Mediat e huaja shkruajnë se 33-vjeçari kishte firmosur një marrëveshje

huazimi me ekipin AmalZulu. Por, gjatë rrugës së kthimit, automjeti i tij është përplasur keq duke i shkaktuar lëndime

fatale mbrojtësit afrikan. Anele Ngcongca pati një karrierë të mirë në Evropë duke fituar 2 tituj kampionë të Belgjikës me

klubin Genk. Ai përfaqësoi Afrikën e Jugut 53 ndeshje, duke marrë pjesë dhe në Kupën e Botës të vitit 2010.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council  
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr. ref. AGJ 1583/2020, si dhe Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr. 450/2020 të datës 23.09.2020, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

### KONKURS

#### I. Zyrtar Ligjor 2

Departamenti për Teknologji Informative , Një (1) pozitë

Referenca: Kodi: KPK/SKPK/ZKPSH/POZ- 001  
Emri Pozitës: Zyrtar Ligjor 2  
Pozita: Pozitë e karrierës  
Niveli: Profesional  
Kodi punës: LI/060  
Grada punës: 8  
Raporton tek: Udhëheqës i Divizionit për sisteme elektronike (softuer)  
Numri i Pozitave: Një (1) pozitë  
Koeficienti: Shtatë, (7)  
Akti i emërimit: Pa afat  
Puna provuese: 12 muaj  
Vendi: Prishtinë

#### Qëllimi i vendit të punës:

Nën mbikëqyrjen e Udhëheqës i Divizionit për sisteme elektronike (softuer), Zyrtari Ligjor 2 është përgjegjës për definimin e të gjitha kërkesave funksionale të sistemeve elektronike si dhe të testimit të sistemeve.

#### Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Analizon (vlerëson përputhshmërinë) ligjeve dhe akteve tjera ligjore në sistemin prokurorial gjatë definimit të proceseve të reja të punës dhe revidimin e atyre ekzistuese.

Bënë definimin e kërkesat funksionale si dhe rishikimin e atyre ekzistuese me qëllim thjeshtëzimit të procedurave aktuale në sistemet elektronik në punë në sistemin prokurorial. Ndërvepron me përdoruesit për të identifikuar kërkesat e tyre lidhur me sistemet elektronike. Përcaktoni të gjitha kërkesat përkatëse të përdoruesit dhe dokumenton ato në një mënyrë të kuptueshme dhe logjike për analiza dhe specifikime të mëtejshme.

Bënë analizimin e proceseve të rregullta rutinore të punës në sistemet elektronik si dhe propozon funksionalitete të reja të cilat ndikojnë në efikasitetin e punës.

Zhvilloni dizajn vizual nga specifikimet dhe kërkesat e dhëna, bazuar në analizën e fushës dhe audicionës së synuar. Krijoni një përfaqësim vizual të ideve të tilla diagrameve etj.

Koordinon punën e avancimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve elektronike përmes raportimit të problemeve tek kontraktorët për problemet e raportuara nga përdoruesit fundor.

Zbaton teknikat dhe mjetet, siç janë sondazhet, pyetësorët, aplikimet e TIK-ut, për nxjerrjen, përcaktimin, analizimin, dokumentimin dhe mirëmbajtjen e kërkesave të përdoruesve për sistemet elektronik që janë në përdorim.

Përgatit udhëzues dhe manuale për përdorimin e sistemeve elektronike.

Bënë testimin e sistemeve elektronike, bëjnë analizimin gabimeve të raportuara nga terreni si dhe paraqet të gjitha problemet të cilat shfaqen në sistemin elektronik të përdoruesit;

Bënë trajnimin e TI regional për përdorimin e sistemeve elektronike.

Kryen çdo detyrë tjetër që korrespondon ose mund të ndihmojë në kryerjen e funksioneve për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin e funksioneve të sistemeve elektronike.

#### Njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë për vendin e punës:

Kuptoj dhe mbështes përkthimin e kërkesave funksionale të sistemeve në prokurori.

Shkathtësi hulumtuese.

Shkathtësi analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale.

Njohuri në përdorimin e kompjuterit (pako Office etj.).

#### Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë Universitare në Fakultetin Juridik .

#### Përvoja e Punës:

Dy (2) vite përvojë punë, prej tyre një (1) vite përvojë pune e obligueshme që lidhet në fushën e TI-së.

#### II. Zyrtar për Transport 3

Prokuroria Themelore Prishtinë, një (1) pozitë

Referenca: Kodi: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ - 002  
Emri pozitës: Zyrtar për Transport 3  
Pozita: Pozitë e karrierës  
Niveli: Administrativ  
Grada: 12  
Raporton tek: Administratori i Prokurorisë  
Kodi punës: AD/1110  
Numri i pozitave: Një (1) pozitë  
Koeficienti: Pesë pikë pesë (5.5)  
Akti i emërimit: Pa afat  
Puna Provuese: Dymbëdhjetë (12) muaj  
Vendi: Prishtinë

#### Qëllimi i vendit të punës:

Ofrimi i shërbimeve të transportit për prokurorë dhe stafin e Institucionit.

Kujdeset për aktivitetet e drejtpërdrejta të lidhura me transportin në institucion dhe mirëmbajtjen e automjeteve.

#### Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Kryen punën e vozitjes së prokurorëve dhe stafit në bazë të orarit dhe caktimeve zyrtare, në nivel të prokurorisë;

Mirëmban automjetin me të cilin kryen detyrat e punës apo me të cilin është i ngarkuar;

Merr pjesë në planifikimin dhe përgatitjen e programit në fushën e transportit dhe siguron mbarëvajtjen e punëve lidhur me shërbimet e transportit;

Është përgjegjës për sigurimin e servisimit dhe mirëmbajtjes së mjeteve transportuese të institucionit;

Mban të dhënat për përdorimin, sevisimin e automjeteve dhe përgatit dokumentet e nevojshëm për përdorimin e tyre;

Kujdeset që automjetet e institucionit të përdorën në mënyrë sa më racionale;

Ofron shërbime të transportit sipas nevojave;

Kryen edhe detyra tjera në pajtim me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen nga mbikëqyrësi.

Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Access, Internet).

#### Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:

Njohuri të duhura profesionale për kryerjen e detyrës së zyrtarit për transport;

Shkathtësi për të caktuar dhe vlerësuar punën sipas rëndësisë dhe prioritetëve;

I gatshëm të punojë me njerëz të etnive dhe religjioneve të ndryshme;

Të ketë gatishmëri për kryerjen e punëve nën presion.

Shkathtësi në aplikacione të programeve: Internet, Word, Excel.

#### Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Shkolla e mesme.

Të posedoj patentë shofer për kategorinë "B".

#### Përvoja e Punës:

Së paku 3 vite përvojë pune.

▪ Konkursi është i hapur 15 ditë kalendrike nga dita e publikimit në faqet zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, si dhe në gazetën ditore, duke filluar nga data 24.11.2020 deri me datë 08.12.2020 si datë e mbylljes së konkursit.

▪ Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në web faqen: [www.prokuroria-rks.org](http://www.prokuroria-rks.org)

▪ Aplikimi në mënyrë elektronike: Pas plotësimit, aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet e skanuara të cilat kërkohen sipas konkursit në formatin PDF, dokumentacioni dërgohet në postën elektronike: [burimet.njerezore@rks-psh.org](mailto:burimet.njerezore@rks-psh.org), ku me pas ju do të pranoni konfirmimin për dërgesën e aplikacionit tuaj në mënyrë elektronike.

▪ Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", nr. 100, Kati 7, zyra nr. 702, 10000 Prishtinë.

▪ Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

▪ Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 18874 prej orës 08:00 – 16:00.

#### Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

- Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

- Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

- "Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."

▪ Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e skanuara të dokumentacionit të kërkuar:

- Dëshminë e kualifikimit shkollor;

- Dëshmi mbi përvojën e punës, Vërtetimi ose kontrata e punës (Letër Referenca apo Rekomandimi nuk pranohet si dëshmi mbi përvojën e punës);

- Dy rekomandime (nëse ken);

- Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);

- Dokumentin e identifikimit-letërnjoftimi i fotokopjuar;

- Certifikatë nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.

▪ Në lidhje me datën e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, kandidatët do të njoftohen bazuar në legjislacionin në fuqi.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council  
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Na osnovu člana 31 Zakona Br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, na osnovu Zakona Br.03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova i Pravilnika Br. 02/2010 o Procedurama Rekrutacije u Civilnoj Službi Kososva, Presude Ustavnog Suda Nr. ref. AGJ 1583/2020, kao i Odluke Tužilačkog Saveta Kosova TSK/Br. 450/2020 datuma 23.09.2020, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, objavljuje sledeće:

### KONKURS

#### I. Pravni Službenik 2

Departman Informativne Tehnologije, jedna (1) pozicija

Referenca: Kod: KPK/SKPK/ZKPSH/POZ- 001  
Naziv Pozicije: Pravni Službenik 2  
Pozicija: Pozicija od karijere  
Nivo: Profesionalni  
Radni Kod: L1/060  
Stepen rada: 8  
Izveštava kod: Rukovodioca Divizije za elektronske sisteme (softuer)  
Broj pozicija: Jedna (1) pozicija  
Koeficijent: Sedam, (7)  
Akt imenovanja: Bez roka  
Probni rad: 12 meseci  
Mesto: Priština

#### Cilj radnog mesta:

Pod nadzorom Rukovodioca Divizije za elektronske sisteme (softuer), Pravni Službenik 2 je odgovoran za definisanje svih funkcionalnih zahteva elektronskih sistema kao i za testiranje sistema.

#### Glavne dužnosti i odgovornosti:

Analizira (ocenuje usgladenost) zakone i druge pravne akte u tužilačkom sistemu prilikom definisanja novih radnih procesa i revizije onih postojećih.

Definiše funkcionalne zahteve kao i pregled postojećih kako bi se pojednostavili trenutni postupci u elektronskim sistemima u radu u tužilačkom sistemu. Postupa u interakciji sa korisnicima radi identifikovanja njihovih zahteva u vezi sa elektronskim sistemima.

Određuje sve relevantne zahteve korisnika i dokumentuje ih na razumljiv i logičan način za dalju analizu i specifikaciju.

Vrši analiziranje redovnih rutinskih procesa rada elektronskih sistema kao i predlaže nove funkcionalnosti koje utiču na efikasnost rada.

Razvija vizuelni dizajn iz zadatih specifikacija i zahteva, na osnovu analize terena i ciljnih audiencije. Stvara vizuelni prikaz ideja poput dijagrama itd.

Koordinira rad na unapređenju i održavanju elektronskih sistema izveštavanjem dobavljača o problemima koje prijavljuju krajnji korisnici.

Primenjuje tehnike i sredstva, kao što su ankete, upitnici, primene TIK-a, za izdvajanje, utvrđivanje, analiziranje, dokumentovanje i održavanje zahteva korisnika za elektronskim sistemima koji su u upotrebi.

Priprema priručnike za upotrebu elektronskih sistema.

Obavlja testiranje elektronskih sistema, vrši analizu grešaka prijavljenih sa terena i predstavlja sve probleme koji se pojavljuju u elektronskom sistemu korisnika;

Sprovodi obuku regionalne IT o upotrebi elektronskih sistema.

Obavlja bilo koji drugi zadatak koji odgovara ili može pomoći u obavljanju funkcija radi povećanja efikasnosti i efektivnosti funkcija elektronskih sistema.

#### Znanja, veštine i sposobnosti za radno mesto:

Razume i podržava prevodenje funkcionalnih sistema u tužilačtvu.

Veštine istraživanja.

Analitičke, ocenjivačke veštine i formulisanje profesionalnih preporuka i saveta.

Znanje u korišćenju kompjutera (paket Office itd.).

#### Stručna priprema i kvalifikovanje:

Univerzitetska Diploma Pravnog Fakulteta.

#### Radno iskustvo:

Dve (2) godine radnog iskustva, od kojih jedna (1) godina obaveznog radnog iskustva iz oblasti IT.

#### Službenik za Transport 3

Osnovno Tužilaštvo Priština, jedna (1) pozicija

Referenca: Kod: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/ POZ -002  
Naziv pozicije: Službenik za Transport 3  
Pozicija: Pozicija karijere  
Nivo: Administrativno  
Grada: 12  
Raportira kod: Administrator Tužilaštvo/Rukovodilac Kancelarije za KZPŽ  
Kod rada: AD/1110  
Broj pozicija: Jedna (1) pozicija  
Koeficijent: Pet tačka pet (5.5)  
Akt imenovanja: Na neodređeno  
Probni rad: Dvanaest (12) meseci  
Mesto: Priština

#### Cilj radnog mesta:

Pružanje usluga prevoza tužioca službenika i osoblja institucije. Pažljiv za direktnim aktivitetima vezana za transport u instituciju i održavanje vozila.

#### Glavne obaveze i odgovornosti:

Završava posao vozača tužilaca i službenika na osnovu rasporeda službenih odredbi na nivou tužilaštva

Održava vozilo sa kojim završava službene obaveze ili sa kojim je zadužen

Prisutan u toku planiranja za pripremu programa na polju transporta i obezbeđuje održavanje poslova vezano za usluge transporta

Odgovoran je za obezbeđenje servisa i održavanja transportnih vozila institucije

Da drži evidenciju korišćenja, servisa vozila i spremi potrebnu dokumentaciju za njihovo korišćenje

Stara se da vozilo institucije da se koriste na racionalan način

Pruža usluge transporta po potrebi

Obavlja i druge zadatke u skladu sa aktualnim zakonima i pravilnicima koje može zatražiti od strane nadzornik.

#### Poznavanja, spretnosti i sposobnosti za radno mesto:

Potrebno profesionalno znanje za obavljanje zadataka vozača

Sposobnosti za određivanje i procenu posla po zadatim prioritetima

Spreman da radi sa ljudima raznih entiteta i religija

Da je spreman za obavljanje posla pod pritiskom

Sposobnosti korišćenja računara i programa (Word, Excel, Power Point, Access, Internet)

Stručna sprema i **Stručna sprema i kvalifikacija:**

Srednja Škola

Vozačka dozvola kategorije "B" obavezna .

#### Radno iskustvo:

Najmanje 3 godine radnog iskustva.

- Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja na službenoj stranici Državnog Tužioca i Tužilačkog Saveta Kosova, kao i u dnevne novine, počevši od 24.11.2020 do 08.12.2020 kao datum isteka konkursa.
- Prijava (aplikacije) za zaposlenje dostupna je na Internetu: [www.prokuroria-rks.org](http://www.prokuroria-rks.org)
- Prijava elektronskim putem:** Nakon popunjavanja prijave priložite skenirane dokumente potrebne konkursom u PDF formatu, dokumentacija se šalje na elektronskom pošte: [burimet.njerezore@rks-psh.org](mailto:burimet.njerezore@rks-psh.org), gde ćete dobiti potvrdu o isporuci svoju prijavu elektronskim putem.
- Prijava poštom:** Zahtevi popunjeni dokumentima takođe se mogu predati poštom Odeljenju za Ljudske Resurse Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova, adresa: Rr. „I.uan Haradinaj“, br. 100 Sprat 7, kancelarija br. 702, 10000 Priština.
- Aplikacije poslate putem pošte, koje sadrže poštanski pečat nad pošiljkom sa datumom poslednjeg dana roka za apliciranje, smatraće se važećim i uzeće se na razmatranje, ako stižu u roku od 4 dana, aplikacije koje stižu posle ovog roka ili su nekompletirane neće se uzeti u obzir uopšte.
- U slučaju potrebe možete da nas kontaktirate na, tel: 038 / 200 18874 od 08:00 do 16:00 časova.
- Uslovi učešća na konkursu:**
  - Pravo apliciranja imaju svi građani Republike Kosova odrasle dobi koji imaju punu sposobnost delovanja, poseduju civilna i politička prava, imaju potrebnu školsku spremu i stručne sposobnosti za vršenje dužnosti kao i fizičkih sposobnosti koja se traže za dotičnu poziciju.
  - Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova i dočekuje aplikacije od sviju osoba muškog i ženskog pola iz redova svih zajednica na Kosovu.
  - Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno zastupanje u organima civilne službe centralne i lokalne državne administracije kao što je specifikovano članom 11, stav 3 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova".
- Aplikacijama se moraju sastaviti kopije zatražene dokumentacije:
  - Svedočanstvo školske spreme;
  - Dokaz o radnom iskustvu; *Potvrda ili radni ugovor.*
  - Dve preporuke *(ako imate);*
  - Kopije dva poslednja naizmenična izveštaja procene rada *(ako takvi postoje);*
  - Dokument identifikacije-fotokopirana lična karta;
  - Uverenje od Suda da niste pod istragom.
- U vezi datuma održavanja pismenog testa i intervjua, za kandidate koji ispunjavaju uslove koji su predviđeni na osnovu ovog konkursa, kandidati biće obavesteni na osnovu važećeg zakonodavstva.**

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- N.S.H. Autoshkolla "Ademi" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810949951.
- JTaulant Gashi shpall te pavlefshme diplomën shmt "11 Marsi " Prizren
- JLuan Berisha shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shmt "11 Marsi " Prizren.
- JGranit Berisha shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf " Asim Maliqaj " Poslisht.
- JAzar Berisha shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf " Arsime Maliqaj " Poslisht.
- Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruge "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

LULËZIM ETEMAJ

Nga motoja e Adem Demaçit „Jo atyne që janë trima me ngrehë gishtin e krimit, por atyne që janë burra me shtri dorën e pajtimit“, të shprehur në romanin „Gjarpijt e gjakut“, e deri te falja e 1169 gjaqeve, 477 plagosjeve dhe 865 ngatërresave, autori i kësaj vepre me vlera të shumfishta nxjerr përpara lexuesit përpjekjet e jashtëzakonshme për ta çliruar popullin shqiptar nga gjarpërinjtë e vërtetë, si parakusht për një mobilizim të përgjithshëm për çlirim kombëtar.


Bardhyl Mahmuti, politolog

Atje ku nuk ka thjeshtësi, nuk ka as madhësi, thotë një kryepenë botërore. Një nga të pesë nismëtarët autentikë të Lëvizjes së Pajtimin të Gjaqeve (1990-1991) që preferuan thjeshtësinë për madhësinë kombëtare, është autori i këtij libri të vonuar tridhjetë vjet, Lulëzim Etemaj. Kjo lëvizje na transformoi në një shkallë më të lartë qytetërimi. Me pajtimin, unitetin dhe solidaritetin që solli ajo, krijoi, në të vërtetë, parakushtet për luftën triumfuese çlirimtare, falë këtij boshti qytetërues dhe drejtimit të saktë gjeopolitik.

Muhamet Mavraj, publicist

LËVIZJA E PAJTIMIT TË GJAQEVE  
NË KOSOVË (1990-1991)

LULËZIM ETEMAJ



## LËVIZJA E PAJTIMIT TË GJAQEVE NË KOSOVË (1990-1991)

ISBN 978-9951-780-24-7  
9 789951 780247


“A po shkruan Barney?”  
 “Ta merr mendja. Shkruaj gjithë kohën e lume”.  
 “A nuk ta ndërpresin punën adhuruesit?”  
 “Jo, ore, ngandonjëherë femrat më gjejnë, ama ato nuk qëndrojnë gjatë”.  
 “A po të shiten librat?”  
 “Po marrë çeçe nga të drejtat e autorit”.  
 “Cila është këshilla juaj për shkrimtarët e rinj?”  
 “Pini, qini dhe pini shumë cigare”.  
 “Cila është këshilla juaj për shkrimtarët e vjetër?”  
 “Në qoftë se ende jeni gjallë, nuk keni nevojë për kurrfarë këshille”.  
 “Çka ju shtyn të shkruani poezi?”  
 “Çka ju shtyn juve të dhjesni?”  
 “Çka mendoni për Reaganin dhe papunësinë?”  
 “S’e çaj kokën as për Reaganin e as për papunësinë. E gjithë kjo më mërzi. Sikur fluturimet në gjithësi dhe Super Bowl”.  
 “Atëherë për çfarë merakoseni?”  
 “Për femrat moderne”.  
 “Për femrat moderne?!”  
 “Po, se ato nuk dinë si të vishen. Këpucët i kanë tmerrësisht të këqija”.  
 “Çfarë mendoni për emancipimin e gruas?”  
 “Sapo të jenë të gatshme të merren me larjen e automobilave, t’i lëvrojnë arat, t’i ndjekin ata dy tipat që e plaçkiten dyqanin e pijeve, apo t’i pastrojnë kanalizimet e ujërave të zeza, kurdo që të jenë të gatshme që bombat në ushtri t’ua hedhin armiqve si sisët në ajër, unë jam i gatshëm të rri në shtëpi dhe t’i laj enët dhe të mërziem duke i mbledhur fijet nga qilimi”.

(Fragment nga tregimi “Emancipimi i gruas”)

4.99 €

ISBN 978-9951-780-19-3  
9 789951 780193

Charles Bukowski • Emancipimi i gruas



## CHARLES BUKOWSKI EMANCIPIMI I GRUAS

Përktheu: Fadil Bajraj







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

